

LIBRI ME KUJTIME

Vdekja e Mit'hat Frashërit, dyshimet për helminin e tij nga agjentët e KGB-së

NGA DR. URAN BUTKA

► FAQE 12-13

LIGJI PER TOKAT

► FAQE 9

Komisioni i Venecias kundër draftit të ri për pronat

Kritika të shumta për hartuesit: Ligj i paqartë dhe i pasaktë, të ndryshohet

[SHQIPTARJA.com]

ÇMIMI 30 LEK | VITI IX - NR. 236(2758) | E PREMTE, 04-10-2019 | www.shqiptarja.com



REFORMA ZGJEDHORE

PS PRANOI KUSHTET E PD DHE OSBE-ODIHR QE NE FUND TE 2018

Drafti i PS që parashikon identifikim, numërin dhe votim elektronik si dhe kufizimin e financimit të fushatave zgjedhore. PD nuk pranon votën e emigrantëve dhe komisionerë jopolitikë. 5 kushtet e fundit të opozitës nuk kanë lidhje me përmbajtjen e reformës

► FAQE 4

KRYEMINISTRI

Rama: Reformën zgjedhore e miratojmë me opozitën e re

► FAQE 2

KREU I PD

Basha: S'ka opozitë të re, zgjedhoren nuk mund ta votosh pa ne

► FAQE 3

LETRA E KREREVE TE BE

Brukseli: Të hapen negociatat për Shqipërinë dhe Maqedoninë

Drejtuesit më të lartë të BE u kërkojnë vendeve anëtarë të japin dritën jeshile për hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë

► FAQE 5

INVESTIMET PUBLIKE

Buxheti afatmesëm, ja rrugët që do të financohen deri në 2022

Shifrat më të larta investohen në Kardhiq-Delvinë dhe Qukës-Qafë Plloçë

► FAQE 8

NGA GENC KONDI

Kryemadhi: LSI-ja nuk i trembet asnjë lloj marrëveshjeje PD-PS

Kryetarja e LSI akuzon Ramën për përgjime: Iku e kaluara, tani opozita është hermetike, s'ka rrjedhje

► FAQE 6

REAGIMI

META: 'VENECIA' U ÇMEND DHE TEJKALOI KOMPETENCAT!

► FAQE 6

Si do funksionojë policia vullnetare, detyrat dhe kriteret

Romina Kuko sqaron rolin e kësaj strukture të re: S'janë spiunë lagjeje

► FAQE 7

Luiza Gega rekord në Botëror pa masazhator e fizioterapist

Kampionia e atletikës shkroi historinë për Shqipërinë shprehet se mund të kishte bërë më mire po të kishte kushte

► FAQE 16

Cyan magenta yellow black

Rama: Në Durrës një prokuror, pjesë e organizatave kriminale

Gjatë diskutimi në Kuvend kryeministri Rama foli për një prokuror që është i lidhur me bandat dhe i bën presion edhe administratës shtetërore. Rama po fliste për reformën në Drejtësi dhe pa dhënë emra tha që në Durrës është ende një prokuror pjesë e bandave ndërsa kërkoi që drejtësia të funksionojë dhe ai të arrestohet. "Vetingu nuk është pushim nga puna, është pastrim i sistemit, krijimi i një sistemi ku gjykatës e prokurorë janë të verifikuar si të pastër e pastaj sistemi do t'i thërrasë do t'i vijë radha, hajde këtu, këto vilat e këto faturat e bixhozit në Monte Carlo me ca i bërë zotrote. Tani ata janë qytetarë të lirë. Prokurori në Durrës që është prokuror dhe punon për organizatat kriminale dhe u bën shantazh nëpunësve të shtetit, mësoje që nuk arreston kryeministri dhe qeveria, por drejtësia dhe procesi i ndërtimit të një drejtësie që arreston është ky që po bëjmë. Po të më kishit mua para 30 vjetësh do flisnit ndryshe, e do flasim ndryshe pas disa vjetësh kur të shikoni që këto që po ju them do jenë fakt", tha Rama.

Rama: Reformën zgjedhore e miratojmë me opozitën e re

Rama: Shqipëria është gati, por sot asnjë vend nuk do futej dot në BE! Hajdari: Rama të hapë krahun dhe të ndryshojë sistemin!

Kryeministri Edi Rama, në fjalën e tij gjatë seancës plenare, bëri të qartë se Shqipëria do të arrijë t'i plotësojë dy kushtet e Bundestagut gjerman për çeljen e negociatave, siç janë Gjykata Kushtetuese dhe e Lartë, dhe miratimi i reformës zgjedhore sipas rekomandimeve të OSBE/ODIHR. Kreu i qeverisë tha se rruga drejt anëtarësimit të BE është e gjatë, dhe nëse Shqipërisë i çelen zyrtarisht negociatat, kushtet që duhet të plotësojë për tu bërë shtet i BE-së janë të shumta. Hapi i parë për t'iu afruar 'PO'-së së negociatave, është reforma zgjedhore, dhe për këtë shefi i mazhorancës kërkoi bashkëpunimin dhe votën e opozitës se re, ndërsa ju përgjigj liderit demokrat Lulzim Basha duke thënë se nuk është në pozitat për të vënë kushte për dialog për zgjedhoren. "T'i thotë një këmbësor që rri tek hija e fikut një makine hap krahun. Me çfarë dekreti hyjnor e ke marrë të drejtën të më çosh mua planin? Kush je ti dhe kë përfaqëson? Ata që përfaqëson i ke lënë në rrugë bashkë me veten, ata janë të mirëpritur në çdo moment, unë ju kam të gjithëve njësoj, juve këtu dhe ata atje, madje për ata kam pak më shumë dhimbje dhe kujdes se janë në hall më të madh, ju nuk jeni në hall të madh, ju keni hallin e Evropës, zotëria atje ka hallin e monarkisë. Hallet tuaja luksoze mbajini vet, se erdhi se nuk erdhi monarkia, ti je mbret pa mbretëri (i drejtohet Kujtim Gjuzit), po mbret je nuk të lëviz njeri nga froni. Gjuz ti nuk je i përgjegjshëm, ti je mbret, je më shumë. Naltmadhëni, ulu, se jemi akoma në republikë. O naltmadhni, dallimi mes meje dhe teje është se ti ke jetuar në luftën e parë botërore, mos më fut në terrenin e luftës se aty me mund. Ti vjen nga lufta e parë, flet me kompetencë. Miqtë e mi, reformën zgjedhore mbi bazën e rekomandimeve të OSBE ta bëjmë urgjent. Ata që janë jashtë nuk e duan. Ju që jeni brenda nuk keni përse të mos e doni. Ju thoni sistemi, ata që janë jashtë nuk e duan se një nga gjërat që do bëjmë bashkë është heqja e komisionerëve politikë. Të bëjmë reformën zgjedhore, të presim të plotësohet Gjykata Kushtetuese dhe e Lartë dhe t'u themi miqve tanë gjermanë, se nuk e dimë çfarë do të shkruhet në vendim, se një vend mund të shtojë ndonjë kusht tjetër, por për sa flasim dhe atyre që u kemi borxhin më të madh në këtë proces, në kuptimin e mirë të fjalës, se nuk na kanë dhënë ndonjë dhuratë, kredi, se na kanë dhënë atë që meritojmë, për të çelur negociatat, ne këto dy kushte ja bëjmë, dhe le të përfitojmë pozitivisht nga qenie e tyre në krah me ne se kushtet e tyre janë plotësuar. Mos të rrimë të presim këtu të biem dakord për të gjitha. Të biem dakord për Evropën që ju e doni shumë dhe e keni në majë të gjuhës sa herë flisni. Një mbreti të vetëm në parlament i lejohet të shkelë rregulloren", tha Rama.

PËR NEGOCIATAT

Kryeministri Edi Rama tha se e ardhmja integruese e Shqipërisë në Bashkimin Evropian nuk lidhet me arritjet e vendit tonë, por me politikën dhe situatën e brendshme aktuale në Bashkimin Evropian. Gjatë fjalës së tij në Kuvend, kreu i qeverisë tha se Shqipëria është gati për të hapur negociatat, por e gjitha do të lidhet me pozitën aktuale të BE-së dhe qëndrimet e disa shteteve si Holanda e Franca që në këtë periudhë kanë mendësi të ndryshme për zgjerimin, dhe nuk është më në dorë të Shqipërisë. "Kur ngrihet pyetja a është gati Shqipëria, në raport me kë? Këtu nis një diskutim real. Sot cilido nga vendet që është në BE aktualisht, nuk do futej në BE dhe madje vende që ishin në BE përpara rënies së komunizmit, nuk do futeshin dot në BE. Sot që flasim, Sepse BE është në një debat të brendshëm i cili nuk ka në konsideratë ekspansionin në BE por daljen nga një situatë e cila e ka vendosur BE në pozitë të vështirë në raport me fuqitë e tjera. Dhe sot debati mes Francës e Gjermanisë, apo mes atyre që e predikojnë zgjerimin hapur pa ngrënë arra në dorë, dhe atyre që nuk e duan zgjerimin, nuk lidhen fare, as me argumentet e përdorura këtu për politike të brendshme, dhe as me Shqipërinë, apo Ballkanin Perëndimor. Shqipëria është shumë më gati për të hapur negociatat seç kanë qenë të gjitha vendet para se të hapnin negociatat. Sepse procesi është bërë shumë më i ndërlikuar dhe shumë më kërkues. Bashkimi Evropian nuk ka sot problem plotësimin ose jo të kushteve nga Shqipëria, por ka probleme të lidhura me një periudhë të tërë krize që ka marrë të përpjetën qysh me shpërthimin e lumit të refugjatëve", tha Rama.

HAJDARI: RAMA TË HAPË KRAHUN

Kryetarja e grupit parlamentar demokrat, Rudian Hajdari tha dje gjatë fjalës në parlament se kryeministri Edi Rama duhet 'të hapë krahun' dhe të ndryshojë sistemin zgjedhor duke bërë lista të hapura. Ajo tha se grupi parlamentar që ajo përfaqëson do jenë të parët si opozitë që vendosin vendin para partisë. "Minimumi që mund të bënte është të thotë do hap krahun dhe të ndryshoj sistemin dhe të bëj lista të hapura. Qeveria bën propagandë gjithandej. Jemi ne dhe ky kryeministër që e ka bërë këtë vend, që shqiptarët të largohen masivisht. Kryeministri është delja e zezë sot, që nuk po i lejon shqiptarët të bëhen pjesë e BE. Rama gënjen herë pas here dhe nuk tregohet i sinqertë. Ne duhet ta ndryshojmë sistemin, sepse e vetmja votë e lirë që do vijë këtu dhe të vetmin njerëz që do e përfaqësojnë këtë Parlament do jenë ata që iu shërbejnë qytetarëve. Sot qytetarët kanë humbur besimin dhe ne duhet të bëjmë çdo gjë për të rikthyer besimin", tha Hajdari.

Për kushtet

"T'i thotë një këmbësor që rri tek hija e fikut një makine hap krahun. Me çfarë dekreti hyjnor e ke marrë të drejtën të më çosh mua planin? Kush je ti dhe kë përfaqëson?".

Për reformën

"Ata që janë jashtë nuk e duan. Ju që jeni brenda nuk keni përse të mos e doni. Të bëjmë reformën zgjedhore, të presim të plotësohet Gjykata Kushtetuese dhe e Lartë".

Bushati:

"Duke notuar kundër rrymës nuk ke suksesin që meriton"

Deputeti socialist Ditmir Bushati u shpreh sot gjatë fjalës së tij në Kuvend se duke notuar kundër rrymës nuk mund të kesh suksesin që meriton , ndërsa deklaroi se në procesin politik për hapjen e negociatave të gjithë janë të vetëdijshëm se secili mund të lërë edhe karrierën politike. Bushati tha se kushtet e Gjermanisë ndaj Shqipërisë nuk duhet të përdoren për të bërë politikë, por duhen parë si detyra shtëpie. "Qëndrimi i Gjermanisë nuk duhet ta në vijë surprizë. Gjermani është vendi që ka investuar më shumë në Ballkan. Në këtë kontekst, pavarësisht se flasim për kushte, besoj se si shqiptarë të mirë që jemi, duhet të flasim për të rritur standardet në jetën e përditshme. Lufta politike në vend është absurde. Leksioni numër një që kam nxjerrë për këtë proces, që të përparojmë na duhet një konsensus kombëtar. Ne kemi notuar kundër rrymës. Të notosh kundër rrymës ti nuk ke suksesin që kërkon. Prandaj kam propozuar një pakt për Evropës, nuk diskutohet se barrën kryesore e ka qeveria, por jo vetëm", u shpreh Bushati.

KUSHTI PËR NEGOCIATAT

Basha-Ramës: Nuk ka opozitë të re, zgjedhoren s'mund ta votosh pa ne

Kreu i PD-së: Reforma Zgjedhore duhet të bëhet në dialog të hapur me të gjitha partitë politike, opozita e re shpikje e mediave

Basha
"Reforma Zgjedhore duhet të bëhet në dialog të hapur me të gjitha partitë politike. Vetëm një njeri që nuk e do çeljen e negociatave thotë e marr dhe e bëj unë vetëm".

Deklaratës së kryeministrit Edi Rama të bërë nga foltorja e Kuvendit se mund ta votojë Reformën Zgjedhore edhe me opozitën e re, kryedemokrati Lulzim Basha iu përgjigj në një dalje për mediat. Basha tha se nuk ka opozitë të re apo opozitë të vjetër, por vetëm një opozitë që përfaqëson shumicën e zgjedhësve në vend. "Nuk ka opozitë të re. Ka vetëm një opozitë e cila përfaqëson sot shumicën e zgjedhësve. Pjesa tjetër është pjesë e një parlamenti monist, termi i opozitës së re është term i medias së kapur nga qeveria. Ka vetëm një opozitë që është PD dhe aleatët e saj", u shpreh Basha. Kreu i PD i kujtoi edhe njëherë Ramës planin me 5 pika për zgjidhjen e krizës politike në vend, dhe për krijimin e Reformës Zgjedhore. Ai akuzoi Ramën se ka dështuar në rrugën e Shqipërisë drejt BE dhe se për këtë faji dhe përgjegjësia është vetëm e tij. "Reforma Zgjedhore është prioritet. Kjo nuk është asnjë beteje as për Edi Ramën dhe as për Lulzim Bashën. Ne kemi propozuar planin për nxjerrjen e vendit nga kriza", u shpreh Basha. Lideri demokrat Lulzim Basha ka zgjedhur t'i përgjigjet deklaratës së Ramës se një karrocë nuk mund t'i thotë një treni hap krahun, me një batutë që kreu i PDK Nard Ndoka bëri dje në studion e Repolitix me gazetarin Denis Minga."Përgjigjen ia ktheu Ndoka kur e quajti rrangallë të vjetër e dalë nga shinat", u shpreh Basha. Edhe njëherë tjetër kryedemokrati Lulzim Basha u shpreh se kryeministri Edi Rama duhet të hapë krahun dhe të lejojnë një vizion të ri në vend. "Të hapë krahun dhe të lejojë një vizion të ri për ta nxjerrë Shqipërinë nga kriza. Nuk e meritojnë shqiptarët të mbeten mbrapa. Duhet një drejtim i ri dhe ky drejtim na duhet shpejt. Reforma Zgjedhore është prioritet. Kjo nuk është asnjë beteje as për Edi Ramën dhe as për Lulzim Bashën. Ne kemi propozuar planin për nxjerrjen e vendit nga kriza", u shpreh Basha.

BASHA: RAMA NUK MUND TA VOTOJNË REFORMËN ZGJEDHORE PA NE!

kryedemokrati Lulzim Basha u shpreh se vetëm një njeri që nuk e do çeljen e negociatave mund thotë se mund ta votojë vetë reformën zgjedhore. Basha tha se ky është shansi i fundit i PS për të kontribuar në zgjidhjen e krizës politike. Basha tha se nuk ka opozitë të re apo opozitë të vjetër, por vetëm një opozitë që përfaqëson sot shumicën e zgjedhësve në vend. "Kushtet e Bundestagut flasin më shumë se fjalët boshe të një njeriu të kapur në dështim. Të merret vendim për Reformën Zgjedhore në përputhje me kushtet e OSBE/ODIHIR. Reforma Zgjedhore duhet të bëhet në dialog të hapur me të gjitha partitë politike. Vetëm një njeri që nuk e do çeljen e negociatave thotë e marr dhe e bëj unë vetëm. Me kë do e bëjë vetëm. Me ata që vjedhin taksat e shqiptarëve. Ky është një sistem që ka degraduar. Ky është shansi i fundit për PS që të kontribuojë në zgjidhjen e krizës së rëndë politike. Opozita ka marrë përgjegjësitë e saj dhe të mos fshihet pas dështimit të radhës sepse vetëm ai është përgjegjës. PD dhe opozita kanë parashtruar një plan me 5 pika. Nuk është hera e parë që Edi Rama fshihet dhe dredhon, por ne do bëjmë gjithçka që kjo të jetë hera e fundit", u shpreh Basha..

'REFORMA ME PERSONA TË INKRIMINUAR'

Lideri demokrat Lulzim Basha u akuzoi kryeministrin Edi Rama se ka zgjedhur të bëjë Reformën Zgjedhore me persona të inkriminuar. Basha tha se Shqipëria do të marrë jo për integrimin evropian për shkak se Shqipëria sot ka arritur në nivel rekord për trafik të drogës. "Vetëm në mendjen e një njeriu që nuk e do integrimin evropian, që do që të fshihet prapë për dështimin tjetër të radhës për hapjen e negociatave, mund të thotë "e marr dhe e bëj vetë" reformën zgjedhore. Me kë do ta bëjë? Me Tom Doshin do ta bëjë? Me Vangjush Dakon? Me Avdylajt? Me Ymer Lalën? Me Jurgis Çyrbjen? Për kë bëhet reforma zgjedhore? Që kriminelët të vazhdojnë të jenë në parlament e të vazhdojnë të marrin vendime në emër të shqiptarëve, të vazhdojnë të grabisin pasurinë e shqiptarëve, bregdetin e shqiptarëve, pyjet, guroret, mineralet, naftën, tokat, taksat, tenderat, koncesionet?! Për këtë bëhet reforma zgjedhore? Sigurisht që jo! Kjo nuk është reformë zgjedhore. Ky është serum për të mbajtur në këmbë një pushtet të degraduar, që ka degraduar zgjedhjet dhe ka degraduar demokracinë, prandaj nuk futemi në Evropë. Për këtë arsye Shqipëria është në krizë ndërsa kushtet e Evropës sa vijnë dhe shtohen. Pse ato vende i thonë PO Maqedonisë dhe JO Shqipërisë. Arsyeja është e thjeshtë se Edi Rama ka dështuar në çdo fushë ku kërkohet progres dhe tani po përpiqet t'i ikër përgjegjësisë. I ka ikur përgjegjësisë duke fshehur faktin se Shqipëria edhe këtë vit ka arritur rekord për trafik të drogës. Edi Rama fakton para shqiptarëve se nuk e do integrimin evropian", u shpreh Basha.

Akuza

Deputeti i opozitës së re kundër të gjithëve në Kuvend

Deputeti i opozitës së re Halit Valteri ka akuzuar deputetët e mazhorancës dhe përfaqësuesit e saj kanë nxirë Shqipërinë përgjatë këtyre viteve. Ai tha se integrimi nuk ka qenë kurrë prioritet për këtë Kuvend. "Disa na shajnë dhe disa na përqeshin dhe të paktë janë ata që i vjen keq për të mjerën Shqipëri. Jemi në luftë kush e kush ta nxijë më shumë Shqipërinë. Në këtë parlament integrimi nuk ka qenë kurrë prioritet. Në listë kryesojnë disa persona që shtojnë sofrën me gjellë pasanikësh. Kjo tufë edhe derrin e bën të skuqet për sojin e tij. Është për të ardhur keq kur sheh se Europa është akoma skeptike. Janë kriminelë që i thërrasin zotëri. Hajdutët që bërtasin kapeni këto hajdutë. I duhet thënë jo shitblerjes së votës, jo presionit për të votuar dhe përralla të tjera si këto", u shpreh Valteri.

Opozita e re

"Nuk ka opozitë të re. Ka vetëm një opozitë e cila përfaqëson sot shumicën e zgjedhësve. Pjesa tjetër është pjesë e një parlamenti monist, termi i opozitës së re është term i medias së kapur nga qeveria".

Gjonaj:

"Mungesa e bashkëpunimit reflektohet negativisht në sy të partnerëve"

Ministrja e Drejtësisë Etilda Gjonaj u shpreh se mungesa e bashkëpunimit mes partive politike do të reflektohet negativisht në sy të ndërkombëtarëve, ndërkohë që i inkurajoji forcat politike që të punojnë së bashku për forcimin e shtetit të së drejtës. "Reforma në drejtësi pavarësisht goditjeve vijon të ecë pa ndalur. Kjo drejtësi do bëjë të mundur luftën kundër krimit dhe korrupsionit. EUROJUST do të mundësojë një bashkëpunim gjyqësor në hetimet e përbashkëta. Po punohet për krijimin e një rrjeti anti-korrupsion. Do të ndiqen rastet korruptive të denoncuara nga qytetarët. Mungesa e bashkëpunimit politik do reflektohet në sy të partnerëve tanë. I inkurajoj të gjithë forcat politike që të punojmë së bashku për forcimin e shtetit të së drejtës", u shpreh Gjonaj.

Miratohet rezoluta për negociatat

Zgjatet Komisioni Hetimor për Ilir Metën

Është miratuar dje nga Kuvendi kërkesa e Komisionit Hetimor për Metën për zgjatjen e punimeve me dy muaj deri në datën 8 dhjetor. Kuvendi votoi me 103 vota pro, asnjë kundër dhe 3 abstenim për të zgjatur punimet për Komisionin Hetimor. Komisioni kërkoi zgjatje të afatit të punimeve për të marrë kohë që të japë një vendim mbi presidentin Ilir Meta, pas publikimit të Opinionit të Venecias me datë 11 Tetor. Kuvendi miratoi me 104 vota edhe rezolutën për mbështetjen e nisjes së bisedimeve për anëtarësim në BE. Para votimit të rezolutës, deputetja socialiste Mimi Kodheli i bëri thirrje palëve politike që të mos të fusin shkopinj nën rrota për të penguar rrugën e Shqipërisë drejt BE. "Kuvendi i ka të gjitha mekanizmat për zbatimin e kushteve të vendosura për çeljen e negociatave. Le t'i japim një shans shpresës sonë evropiane duke punuar bashkë dhe pa shkopinj nën rrota. Duhet bashkëpunim që Shqipëria të marrë PO për çeljen e negociatave sepse shqiptarët e meritojnë", u shpreh Kodheli.

Drafti i PS që pranon kushtet kryesore të PD për reformën zgjedhore

Në fund të 2018 PS dorëzoi në Kuvend draftin për ndryshimin e Kodit Zgjedhor, përfshin kushtet e PD për teknologjinë në zgjedhje dhe financimin e fushatave si dhe rekomandimet e OSBE/ODIHR

Opozita e bashkuar deklaroi të mërkurën se i përgjigjet pozitivisht ftesës së partnerëve ndërkombëtarë për reformën zgjedhore, por në të njëjtën kohë shpalli pesë kushte në këmbim të angazhimit të saj. Por, kushtet e fundit të opozitës konsistojnë në mënyrën e realizimit të reformës zgjedhore dhe jo për përmbajtjen e saj. Njëkohësisht kryeministri Edi Rama, në një intervistë për Report Tv, ka pohuar se për të plotësuar kushtet e vendosura nga Gjermania për të hapur negociatat, mjafton të votohen ndryshimet në Kodin Zgjedhor që përputhen me rekomandimet e OSBE-ODIHR dhe që janë të shkruara, pa pritur mbështetjen nga PD dhe LSI. Një gjë e tillë u kundërshtua ashpër dje nga kreu i opozitës së bashkuar Lulzim Basha. Në fakt, sa i takon përmbajtjes së ndryshimeve të Kodit Zgjedhor, Partia Socialiste, që nga viti i kaluar, ka pranuar pothuajse të gjitha kushtet e Partisë Demokratike. Në 18 dhjetor të 2018, Partia Socialiste, përmes 9 deputetëve, depozitoi një draft për ndryshimin e Kodit Zgjedhor. Drafti reflekton të gjitha rekomandimet e OSBE/ODIHR për zgjedhjet lokale dhe vendore që janë organizuar në Shqipëri si dhe dy kërkesat kryesore të Partisë Demokratike.

1. TEKNOLOGJIA NË ZGJEDHJE

Kushti kryesor i Partisë Demokratike për reformën zgjedhore është përdorimi i teknologjisë në zgjedhje, konkretisht identifikimi biometrik i zgjedhësve, votim dhe numërim elektronik. Ky propozim kushtëzues i PD parashikohet në nenet 4, 5 dhe 6 të draftit të PS, duke ngarkuar KQZ, për të eksploruar, eksperimentuar dhe vendosur përdorimin e sistemeve elektronike në zgjedhje. Përdorimi i teknologjisë në zgjedhje duhet të aplikohet vetëm pasi të testohet me sukses. “Sistemet ose pajisjet e teknologjisë së informacionit që KQZ-ja vendos të përdoren në zgjedhje duhet të synojnë në radhë të parë identifikimin biometrik të votuesve, votimin nëpërmjet pajisjeve elektronike si dhe numërimin e votave të hedhura. Përzgjedhja dhe përdorimi i sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit i nënshtrohen parimeve të ligjshmërisë, transparencës, sigurisë, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë”, thuhet në draftin e PS.

2. FINANCIMI I FUSHATAVE ZGJEDHORE

Partia Demokratike ka kërkuar financim shtetëror 100% të procesit zgjedhor dhe fushatës së partive. Drafti i PS parashikon disa kufizime të forta sa i takon financimit dhe shpenzimeve në fushatë. Sa pari, parashikon uljen e pragut të dhurimit ndaj partive dhe kandidatëve nga 100 mijë lekë që parashikon Kodi në fuqi në 30 mijë lekë. Po ashtu, personat që kanë bërë dhurime për kandidatët apo partitë nuk mund të marrin tendera apo të ligjin kontrata me institucionet publike për një periudhë deri në 3 vjet me një vlerë totale prej 10 milionë lekë. Së dyti, është parashikuar që shuma e shpenzimeve të bëra nga një parti politike në fshatë, përfshirë edhe kandidatët e saj, nuk duhet të jetë më shume se 2 herë më e madhe se shuma që ka marrë subjekti zgjedhor nga fondet publike për qëllime zgjedhore. Po ashtu, partitë politikë dhe çdo kandidat e ka të ndaluar bërjen e reklamave politike në mediat publike e private kundrejt pagesës 3 muajt fundit para zgjedhjeve. Këtë ndalim e kanë edhe institucionet shtetërore.

SISTEM MASASH KUNDËR SHITBLERJES SË VOTËS

Partia Demokratike ka kërkuar gjithashtu sistem masash kundër shitblerjes së votës, dekriminalizim të procesit zgjedhor, Veting politikës dhe pastrimi i Policisë së Shtetit nga lidhjet me krimin. Në këtë aspekt, drafti i PS parashikon krijimin e një portali nga KQZ për të denoncuar të gjitha shkeljet e ligjit zgjedhor. Gjithsesi, këto kushte nuk mund të adresohen plotësisht në Kodin Zgjedhor, por mbetet në vullnetin e partive për të ashpërsuar dënimet në Kodin Penal për krimet zgjedhore. Një pjesë e këto ashpërsimeve janë bërë. Sa i takon Vetingut në politikë, një kush i tillë u rrëzuar nga Komisioni i Venecias, ndërsa për pastrimin e policisë nga krimi po zbatohet Vetingu në polici.


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/________

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10019, DATË 29.12.2008 "KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 81 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e ______________.

KUVENDI I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 bëhen këto nd...
- Pika 21 riformulohet si ...
"Votim për të tretët" ësht...
tjerë, të pranishëm ose jo...
108 të këtij Kodi, votim...
- Shtohet pika 21/1 me ...
"Votim familjar" ësht...
rregull kryefamiljari. ...

Pas nenit 3 shtohet ...

- Pika 17 ndryshohet si vijon: "17. Shqyrton dhe zgjidh ankesat e subjekteve zgjedhore dhe individëve në lidhje me shkeljet e mundshme të ligjit gjatë fushatës zgjedhore dhe procesit zgjedhor në përputhje me rregullat e këtij Kodi."

Pas pikës 18 shtohen pika 18/a dhe 18/b me këtë përmbajtje:
"18/a. Miraton rregullat dhe formularët për raportimin mbi financimin e fushatave zgjedhore, monitoruesit e financimit të fushatave dhe për raportimin financiar të audituesve të pavarur të fushatave.
18/b. Krijon, si dhe miraton rregullat e organizimit dhe funksionimit të Qendrës së Trainimeve të Administratës Zgjedhore, përcakton procedurat e aplikimit dhe të përzgjedhjes, si dhe realizon trainimin fillestar dhe vazhdues të administratorëve zgjedhorë."

Neni 5

Neni 21/1 dhe neni 21/2 ndryshohen si vijon:

"Neni 21/1
Kompetencat e KQZ-së lidhur me teknologjinë në zgjedhje

1. KQZ-ja ka të drejtë të eksplorojë, eksperimentojë dhe të vendosë përdorimin në zgjedhje të sistemeve dhe/ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit, për të mbuluar aspekte dhe/ose procedura të veçanta të procesit zgjedhor, si dhe ka të drejtë të prokurojë sisteme apo pajisje të teknologjisë së informacionit apo edhe shërbimin e operimit të tyre.
2. Përdorimi i sistemeve ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit bëhet në përputhje me rregullat e posaçme lidhur me procedurat për aspektet e veçanta të procesit që mbulohen nga sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit. Rregullat procedurale për këtë qëllim miratohen me akt normativ të KQZ-së.
3. Sistemet ose pajisjet e teknologjisë së informacionit që KQZ-ja vendos të përdoren në zgjedhje duhet të synojnë, në radhë të parë, identifikimin biometrik të votuesve, votimin me dhe nëpërmjet pajisjeve elektronike, si dhe numërimin nga pajisjet të votave të hedhura. Identifikimi, përzgjedhja dhe përdorimi i sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit i nënshtrohen parimeve të ligjshmërisë, transparencës, gjithëpërfshirjes, sigurisë, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë.
4. Përpara çdo procesi zgjedhor, sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit duhet t'i nënshtrohen testimit operacional nga KQZ-ja, në seanca publike dhe me procedurë të saktë dhe të detajuar, duke përzgjedhur, me kriter rastësor për secilën zonë zgjedhore, jo më pak se tri për qind të pajisjeve që do përdoren dhe duke simuluar me to veprimet operacionale zgjedhore, për një numër jo më të vogël se 50 votues.
5. Pas çdo procesi zgjedhor, pas nxjerrjes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve ...

Drafti

Në 18 dhjetor të 2018, Partia Socialiste depozitoi në Kuvend një draft për ndryshimin e Kodit Zgjedhor, i cili reflekton të gjitha rekomandimet e OSBE/ODIHR dhe dy kërkesat kryesore të Partisë Demokratike.

Negociatat

Reforma zgjedhore është një nga dy kushtet e vetme të vendosura nga Bundestagu gjerman për çeljen e negociatave për integrimin e Shqipërisë në BE

KUSHTET E PD PËR REFORMËN ZGJEDHORE	
1.	Përdorimi i teknologjive në votim, identifikim biometrik të votuesve, votim dhe numërim elektronik.
2.	Financim shtetëror 100% të procesit zgjedhor dhe fushatës së partive.
3.	Sistem masash kundër shitblerjes së votës, dekriminalizimi i procesit zgjedhor – Veting i politikës-pastrimi i Policisë së Shtetit nga lidhjet me krimin.

PARASHIKIMET E DRAFTIT TË PS	
1.	Përdorimi i teknologjive në votim, identifikim biometrik të votuesve, votim dhe numërim elektronik.
2.	Pragu i dhurimit ndaj partive dhe kandidatëve ulet nga 100 mijë lekë në 30 mijë lekë.
3.	Personat që i bëjnë dhurime një partie nuk mund të marrin përfitojnë para publike mbi 10 milionë lekë, për një periudhë 3-vjeçare.
4.	Shpenzimet e partive nuk duhet të jenë më shumë se sa dyfishi i shumës që marrin nga buxheti i shtetit.
5.	Ndalimi i reklamave politike në media kundrejt pagesës 3 muaj para zgjedhjeve.
6.	Portal nga KQZ për denoncime në lidhje me financimet e fushatës.
7.	Rregulla të forta për afishimin e materialeve propagandistike.
8.	Komisioneri jopartiakë të zgjedhur me short nga KQZ
9.	Votim nga emigrantët.
10.	Vendosje e kuotave gjinore në jo me pak se 30 për qind të përbërjes së Kuvendit dhe organeve të organeve vendore.
11.	Vendosje e kuotave gjinore në jo me pak se 30 për qind të administratës zgjedhore.

KËRKESAT E PARTITIVE TË VOGLA	
	NDRYSHIMI I SISTEMIT ZGJEDHOR
1.	Korrektimi i sistemit proporcional rajonal, duke përfshirë korrektimin kombëtar të votave
2.	Votim elektronik dhe numërimin elektronik të votave
3.	Realizimin e identifikimit biometrik të zgjedhësve
4.	Transparencë e financimit të partive
5.	Të ulet kostoja e fushatës zgjedhore në mënyrë drastike
6.	Të forcohen ndalimet për financimin dhe të forcohen penalitetet
7.	Garantimi i aksesit të drejtë në media dhe mbulimi mediatik
8.	Reduktimi e nominimi i hapësirës publicitare në fushatën zgjedhore
9.	Ndalim rreptësisht përdorimit të burimeve njerëzore të administratës publike

DISA NGA REKOMANDIMET E OSBE/ODIHR	
1.	Të depolitizohen komisionet zgjedhore
2.	Jo filmime të prodhuara nga partitë politike që transmetohen në lajme.
3.	Të rregullohet çështja e adresave të zgjedhësve.
4.	Rregullat më të forta për regjistrimin e kandidatëve.
5.	Të mos ushtrohet presion ndaj punonjësve të sektorit publik.
6.	Të trajtohet problemi i shitblerjes së votës.
7.	AMA duhet të monitorojë median gjatë dhe ndërmjet zgjedhjeve.
8.	Vëmendje duhet t'i jepet rishikimit të metodologjisë së BMM-së.
9.	Duhet të mendojnë për të fuqizuar transmetuesin publik shtetëror.
10.	Të dhëna të sakta mbi pronësinë e mediave duhet të bëhen publike.
11.	Vëmendje duhet t'i kushtohet rritjes së transparencës në procesin e nxjerrjes së rezultateve.

Brukseli: Të hapen negociatat për Shqipërinë e Maqedoninë

Drejtuesit më të lartë të institucioneve të BE u kërkojnë vendeve anëtarë të unionit që të japin dritën jeshile për hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë: Bënë atë që u kërkuam

Drejtuesit më të lartë të institucioneve në Bruksel në unison përmes një letre u kërkojnë vendeve anëtarë të BE-së që të japin dritën jeshile për hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, pasi i kanë plotësuar të gjitha kushtet që u kërkuan. Letra është firmosur nga Presidentja e Komisionit Europian Ursula Von der Leyen, ai në largim Jean-Claude Juncker, kryetari i Parlamentit Evropian David Sassoli dhe Presidenti i Këshillit Europian Donald Tusk. "Qershorin e kaluar u pajtuam të arrinim një vendim të qartë dhe thelbësor për hapjen e negociatave të pranimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë jo më vonë se tetori 2019. Bashkimi Evropian qëndron para një zgjedhjeje strategjike. Nëse BE vendos tani për të filluar bisedimet e pranimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë është një provë e aftësisë së Unionit për të përmbushur premtimet e tij dhe për të parë të ardhmen. Bota jonë po pëson ndryshime të shpejta. Nëse BE do të ruajë rolin e saj ndërkombëtar dhe të mbrojë interesat e saj, ndërmarrja e një hapi drejt integrimit të atyre vendeve

Brussels, 3 October 2019

Dear colleagues,

Last June we agreed to reach a clear and substantive decision on the opening of accession negotiations with North Macedonia and Albania no later than October 2019.

The European Union stands before a strategic choice. Whether the EU decides now to open accession talks with North Macedonia and Albania is a test of the Union's ability to deliver on its promises and look to the future.

Our world is undergoing rapid changes. If the EU is to uphold its international role and protect its interests, taking a step towards integrating those European countries that have expressed an interest and have fulfilled the requirements for starting the accession process will help achieve this.

North Macedonia and Albania did what we asked them to do. Achieving that required a significant effort from their citizens, for whom the European perspective has been a great source of motivation and determination.

There is no guarantee of success. There will be a lot of hard work on reforms along the way. Membership will not happen overnight. And both countries are aware of this. In parallel, EU cooperation will have to deepen to go along with the widening, in the mutual interest of European and candidate countries' citizens.

We believe that now is the time to open accession talks with both countries.

Yours sincerely,

David Sassoli, President European Parliament
Donald Tusk, President European Council
Jean-Claude Juncker, President European Commission
Ursula von der Leyen, President-elect European Commission

evropiane që kanë shprehur interes dhe kanë përmbushur kërkesat për fillimin e procesit të pranimit do të ndihmojë në arritjen e kësaj. Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria bënë atë që u kërkuam të bënin. Arritja e kësaj kërkonte një përpjekje të konsiderueshme nga qytetarët e tyre, për të cilët perspektiva evropiane ka qenë një burim i shkëlqyeshëm i motivimit dhe vendosmërisë. Do të ketë shumë punë të vështirë për reformat gjatë rrugës. Anëtarësimi nuk do të ndodhë brenda natës. Dhe të dy vendet janë të vetëdijshëm për këtë. Paralelisht, bashkëpunimi i BE-së do të duhet të thellohet për të ecur së bashku me zgjerimin, në interesin e ndërsjellë të qytetarëve të vendeve evropiane dhe ato kandidate. Ne besojmë se tani është koha për të hapur bisedimet e pranimit me të dy vendet", mbyllet letra. E ndërsa Gjermania tha 'PO', dy vendet skeptike deri tani janë Franca dhe Holanda. Presidenti francez kërkon më parë një reformim të BE-së më pas zgjerim, por krerët e Brukselit theksojnë në letrën e tyre se hapja e negociatave nuk do të thotë se Shqipëria dhe Maqedonia do të anëtarësohen brenda natës në BE. Vendimi për hapjen e negociatave do të merret në mes të tetorit.

Letra

Drejtuesit më të lartë të institucioneve në Bruksel në unison përmes një letre u kërkojnë vendeve anëtarë të BE-së që të japin dritën jeshile për hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

NEGOCIATAT? HOLANDA: DO TË FLASIM NË JAVËT E ARDHSHME

Kryeministri holandez, Mark Rutte vizitoi Berlinin të mërkurën me kabinetin e tij qeveritar për të biseduar mbi bashkëpunimin gjermane në fushën e mbrojtjes së klimës dhe zhvillimit të energjive të rigjenerueshme. Por në konferencën e shtypit bashkë me kancelaren Merkel ai u shpreh edhe në lidhje me hapjen e negociatave të BE me Shqipërinë e Maqedoninë e Veriut. I pyetur nëse Holanda do të japë përgjigje pozitive për hapjen e negociatave, Rutte u shpreh se kemi ende shqetësime. "Ne, si shumë vende të tjera ende jemi të shqetësuar - diçka më pak për Maqedoninë e Veriut dhe më shumë për Shqipërinë. Pyesim veten, se sa përpara ka shkuar progresi në Shqipëri, dhe aty kemi më shumë shqetësime. Për këtë ne do të flasim në javët e ardhshme edhe me partnerët evropianë, sepse jemi vërtet të shqetësuar, për masën e progresit të arritur. Maqedonia e Veriut ka arritur më shumë se Shqipëria, dhe për këtë do të ketë ende bisedime". Gjermania dha dritën jeshile për negociatat, ndërsa tashmë pritet se cili do të jetë vendimi i Francës dhe Holandës që janë dy vendet e tjera skeptike.

'Akull' në 'Tetorin Gjerman', Meta i ftohtë me Ramën

Prej kohësh kryeministri Edi Rama dhe presidenti i vendit Ilir Meta kanë hedhur akuza ndaj njëri-tjetrit, dhe marrëdhënia e tyre ka qenë e akullt. Pas një lufte politike, e cila prej disa muajsh ka përplasur institucionalisht disa herë kryeministrin Edi Rama dhe presidentin Ilir Meta, ata sot u gjenden në të njëjtin vend vetëm disa metra larg njëri-tjetrit. Edhe dje, pavarësisht se janë bërë bashkë në organizimin e Ambasadës Gjermane me rastin e 3 tetorit që shënon bashkimin e Gjermanisë, marrëdhënia e Ramës dhe Metës ka vijuar e ftohtë, pa asnjë shikim apo shtrëngim duarsh. Në këtë ceremoni ka qenë i pranishëm edhe kreu i grupit parlamentar të PS, Taulant Balla, së bashku me kreun e Kuvendit Gramoz Ruçi. Por ndryshe nga socialistët e tjerë, Meta është takuar 'kokë më kokë' me Kreun e Kuvendit Gramoz Ruçi. Presidenti ka bërë edhe një reagim në rrjetet sociale në lidhje me këtë event të organizuar nga Ambasada Gjermane, ku ka shpërndarë edhe disa foto nga eventi. Presidenti është kujdesur që në foto në asnjë vend të mos duket kryeministri Rama, ndërkohë me Ruçin ka postuar një foto ku shihen bashkë. Pas nismës së kuvendit për shkarkimin e tij si shkelës i rëndë i kushtetutës, Ilir Meta ka hedhur edhe publikisht akuza të rënda në drejtim të qeverisë, duke e quajtur "shtet të propagandës dhe PPP-ve". "Kënaqësi të merrja pjesë sot në pritjen e organizuar nga Ambasada Gjermane në Tiranë, me rastin e 3 tetorit, Ditës së Bashkimit të Gjermanisë dhe t'i shprehja ambasadorit Peter Zingraf urimet më

të ngrohta e të përzemërta për popullin mik gjerman. Shqipëria do vijojë të mbështetet fort në Gjermaninë mike dhe partnere strategjike. Mirënjohje të thellë për kontributin e çmuar, të gjithanshëm dhe të përhershëm që Gjermania i ka dhënë Shqipërisë në procesin e integrimit evropian, konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe reformave demokratike!", ka shkruar Meta krahas fotove të publikuara. Aktivitet e "Tetorit Gjerman" do të vijojnë gjatë të gjithë muajit me shtrirje kulturore, artistike, sociale dhe politike. Tetori Gjerman është shndërruar tanimë në një eveniment të për vjetshëm në jetën kulturore të Shqipërisë dhe gëzon një efekt të qartë identifikimi si i tillë. Ai simbolizon angazhimin e madh të Gjermanisë në Shqipëri dhe marrëdhëniet intensive gjermano-shqiptare.

Kujtim Gjuzi në '45 Minuta': Meta të dorëhiqet, Edi Rama president

Iftuar në emisionin "45 minuta" në Report TV, ditën e djeshme ka qenë deputeti Kujtim Gjuzi. Ai ka komentuar situatën politike në vend. Sipas Gjuzit, Presidenti Ilir Meta, duhet të japi dorëheqjen dhe kjo është mënyra më e mirë për ta larguar atë. Më pas Gjuzi ka thënë se tek socialistët ekziston një ide për të vendosur kryeministrin Rama si President. Megjithëse ka thënë se ai nuk do ta jepte votën e tij për të vendosur Ramën si President, Gjuzi ka thënë se këtë ide për Ramën President e ka konfirmuar nga një eksponent i lartë i Partisë Socialiste. "Pata një takim me një eksponent të lartë nga PS u thash për Metën. Meta tha ka mbaruar punë. Por po dha dorëheqjen shpëtojmë të gjithë", ka thënë Gjuzi. "Socialistët kanë thënë duam ta qetësojmë dhe ta çojmë President; Por unë nuk ja jap votën time", ka shtuar më pas ai. Ndër të tjera Gjuzi ka folur edhe për zëvendësin e Ramës si kryeministër ku sipas tij, kreu i opozitës që pretendon këtë post, Lulzim Basha nuk mund ta marrë kurrë këtë detyrë, pasi ai është përgjegjës për vrasjen e 4 protestuesve më 21 janar 2011, kohë kur ai ishte ministër i Brendshëm. Sipas Gjuzit, një emër që mund të zëvendësojë Ramën është, ministrja për Marrëdhëniet me Parlamentin, Elisa Spiropali. Po kështu si një emër tjetër Gjuzi ka përmendur edhe doktoreshën Klodiana Spahiu. "Kur i kam thënë Bashës se ti je përgjegjës për vrasjen e 4 protestuesve më 21 janar. Nuk ka shansin të bëhet kryeministër. Mund të bëhet Spiropali por jo ai. Ai ka përgjegjësi. Ose Klodiana e Durrësit, mjeke", ka thënë Gjuzi. Ndër të tjera Gjuzi ka komentuar edhe debatin që ka me kryeministrin Rama, ku ky i fundit nga foltorja e Kuvendit e quajti me ironi Gjuzin si 'Mbret'.

Kryemadhi: LSI-ja nuk i trembet asnjë lloj marrëveshjeje PD-PS

Kryetarja e LSI akuzon Ramën për përgjime: Iku e kaluara, tani opozita është hermetike, s'ka rrjedhje

Kryetarja e LSI-së Monika Kryemadhi deklaroi në një intervistë për Report Tv se nuk i trembet asnjë lloj marrëveshje PD-PS. Ajo u shpreh se ditën që politika shqiptare do ta institucionalizojë dialogun nuk do të ketë më krizë politike dhe Shqipëria do të vazhdojë e sigurt drejt gjithë proceseve të saj për integrimin evropian. "Unë mendoj që ky koncept ekziston vetëm në pyetjet e gazetarëve. Nuk është çështje marrëveshjeje PD-PS, PS-LSI, PD-LSI nuk është më çështje marrëveshjeje këtu. Është çështja e hapave që do të ndiqen nga politik bërësit, kur them politikbërësit të gjitha forcat politike, si ato parlamentare dhe jo parlamentare. Kur vjen reforma zgjedhore dhe zbatimi i saj. Vërtet miratohet një reformë zgjedhore por ajo duhet zbatuar, por si zbatohet një reformë zgjedhore? Me zgjedhje. Që të shkosh në një proces zgjedhor. Nuk është çështje marrëveshje këtu është çështje dialogu. Institucionalizimi i dialogut. Ne akoma e mendojmë dialogun politik gjë që e ke kusht nga Bashkimi Europian që në propozimin e parë për hapjen e negociatave është dialogu politik. Dialogu politik është institucion. Ne duhet ta institucionalizojmë. Ne nuk kemi dialog politik. Vazhdojmë 30 vjet tranzicion. Pse kemi 30 vjet tranzicion? Sepse nuk kemi dialog politik. Ditën që politika shqiptare do ta institucionalizojë dialogun, ju do ta shikoni që nuk do të ketë më krizë politike dhe Shqipëria do të vazhdojë e sigurt drejt gjithë proceseve të saj për integrimin evropian. LSI-ja nuk i trembet asnjë lloj marrëveshjeje, jo vetëm LSI dhe PD-ja dhe të gjitha partitë e tjera. Jemi shumë të qarta në axhendën tonë dhe në objektivin tonë", tha ajo ndër të tjera.

Mandatet
"Për hir të së vërtetës opozita mori një vendim ekstrem politik që nuk ka ndodhur ndonjëherë. Ishte si të themi një vetëvrasje politike, është e vërtetë, por nuk jemi bërë pishman në asnjë moment".

KRYEMADHIN AKUZON RAMËN PËR PËRGJIME

Kryetarja e LSI Monika Kryemadhi thotë se opozita ka ndërtuar një strategji hermetike për të parandaluar rrjedhjen e informacionit te kryeministri Rama, ndërsa e akuzon edhe për përgjime. "Ne kemi qenë gati gjithmonë. Opozita ka qenë e gatshme gjithmonë për të shkuar në zgjedhje, pavarësisht po themi gosipeve që hidhen poshtë e përpjetë, edhe mungesës së informacionit për hir të së vërtetës që ka Rama nga opozita. Sepse ndryshe nga herët e tjera, është një strategji më e organizuar dhe më hermetike. Sepse rrjedhja e informacioneve ka qenë gjithmonë ajo që i ka dhënë Ramës mundësinë marrjes dhe të lëvizjes. Për hir të së vërtetës nëpërmjet sistemit të përgjimeve që ka, nëpërmjet sistemeve të networkut që ka, të gjithë funksioneve të Policisë së Shtetit, të Shërbimit Informativ, të gjithë strukturave të ushtrisë. Neve një video na del në televizion dhe kompania e cila është e licencuar nga Endri Fuga na e heq të drejtën, heq fytyrën time dhe zërin tim sepse paska ai të drejtën e thënieve të mia që them unë në televizionin tuaj, dhe nuk e paskam unë. Ma heq mua nga Facebook-u dhe nga rrjetet e mia sociale. Me ç'të drejtë? Kjo sepse nuk do që të shpërndahet një video e një opozitari. Ama kur janë videot, intervistat e qeveritarëve, apo të njerëzve që u pëlqejnë Edi Ramës nuk e paska ai të drejtën e autorit", tha ajo.

KRYEMADHI: DJEGIA E MANDATEVE ISHTE VETËVRASJE POLITIKE

Kryetarja e LSI-së Monika Kryemadhi e pranon se djegia e mandateve ishte një vendim ekstrem dhe vetëvrasje politike për opozitën. "Për hir të së vërtetës opozita mori një vendim ekstrem politik që nuk ka ndodhur ndonjëherë. Ishte si të themi një vetëvrasje politike, është e vërtetë, por nuk jemi bërë pishman në asnjë moment sepse sot e kësaj dite ne kemi një raport të OSBE-ODHIR që flet për reformën në drejtësi që përdoret nga qeveria dhe mazhoranca për të kërcënuar gjyqtarët që të japin vendime gjyqësore në favor të tyre, kemi këtë raport që gjykon 3 herë, që nuk ka bërë vaki të thotë në 3 paragrafë që Prokuroria nuk ndëshkon krimin elektoral. Dhe mungesa e ndëshkimit të krimit elektoral intimidon qytetarët që të shkojnë të votojnë. Edhe në 1997 që raporti ka qenë po e njëjta ambasadore që ka bërë raportin e OSBE/ODHIR kundër zgjedhjeve të 1996 të Sali Berishës, pra në të gjitha proceset zgjedhore që nga 91 deri në 2019 asnjëherë KQZ, nuk është anatemuar nga raportet e OSBE-ODHIR, si një instrument i kapur politikisht ose që është kthyer në një seksion politik partiak. Pra janë të gjitha gjërat ato që ne kemi thënë. Mos të harrojmë që ky raport na ka bërë një skaner të instrumenteve shtetëror dhe sesi është i gjithë procesi dhe sistemi", kryemadhi.

KOMISIONI I VENECIAS

Për kryetaren e LSI-së Monika Kryemadhi nuk është vetëm Presidenti Ilir Meta që e ka tejkaluar kompetencat, por edhe Komisionit i Venecias, sepse sipas saj, ka dhënë edhe një argumentim më të madh se ç'duhet, pra ka kaluar pyetësorin e tij. "Nuk më krijon asnjë lloj ndjesie, ai është një draft paraprak, mund të them që unë nuk jam një juriste që ta analizoj. Më duket si një deklaratë politike, pavarësisht nga kjo unë nuk jam e aftë për të gjykuar personat që e kanë hartuar atë draft. Ajo që më bën përshtypje është që, me sa kam lexuar në letrën e Z. Ruçi, nuk është kërkuar opinion nga Komisioni i Venecias për zgjedhjet e 30 qershorit por është kërkuar një opinion vetëm për dekretet e Presidentit. Komisioni i Venecias ka tejkaluar kompetencën e tij duke dhënë edhe një argumentim më të madh se ç'duhet, pra ka kaluar pyetësorin e tij, ka dalë në 30 qershor. Kështu që kemi një President që ka tejkaluar kompetencat, kemi edhe një Komision të Venecias që ka tejkaluar kompetencat. Kështu që, unë di të them që për mua, Komisioni i Venecias mos të harrojmë ka dhënë edhe një sugjerim në 2016-ën ku Shqipëria nuk duhet të qëndrojë asnjë ditë pa Gjykatë Kushtetuese. Ne kemi hyrë në vitin e tretë pa Gjykatë Kushtetuese kështu që Komisioni i Venecias është një sugjerim që kush të dojë e merr parasysh. Mendoj që është më shumë një anije letre në furtunën e gotës, në mënyrë të tillë për të larguar vëmendjen nga kushtet e Bundestagut", vijoi Kryemadhi.

'ÇFARË MË THOTË META SAPO HAP SYTË ÇDO MËNGJES'

Por si e shikon Presidenti i vendit, Ilir Meta njëkohësisht bashkëshort i kryetares së LSI-së, aksionin opozitar dhe çfarë diskuton me Kryemadhin në familje për këtë çështje? "Me thënë të drejtën nuk e pyes, di të them që është i pakënaqur për çështjen e mandateve, sapo hapim sytë në mëngjes, nuk fillojmë me 'mirëmëngjesi, si fjete' por 'pse i dogjët mandatet' kështu që, për sa i përket kësaj gjëje, meqenëse pyetët edhe si ish kryetar i partisë edhe si bashkëshort njëkohësisht. Ndërsa për sa i përket si President, të jeni të bindur që për sa i përket aksionit opozitar unë nuk ndaj asgjë me të. Sepse ajo çfarë unë jam e angazhuar në tryezën e opozitës vjen si rezultat i vendimmarrjes me strukturat e partisë dhe më pas ajo reflektohet në tryezën e partive politike të frontit opozitar", tha ajo.

Kryemadhi
"Ditën që politika shqiptare do ta institucionalizojë dialogun, ju do ta shikoni që nuk do të ketë më krizë politike. LSI-ja nuk i trembet asnjë lloj marrëveshjeje, jo vetëm LSI dhe PD-ja dhe të gjitha partitë e tjera. Jemi shumë të qarta në axhendën tonë dhe në objektivin tonë".

A DO TA JAPË DORËHEQJEN? / META: S'E LË SHQIPËRINË NË KAOS

Meta: 'Venecia' u çmend dhe tejkaloi kompetencat!

Presidenca do të bëjë sot publik qëndrimin për draft-opinionin e Komisionit të Venecias, lidhur me kërkesën e mazhorancës për shkarkimin e Ilir Metës, me argumentin se ka shkelur Kushtetutën me anulimin e zgjedhjeve të 30 qershorit. Por, Presidenti i Republikës, Ilir Meta tha në "Opinion" mbrëmë se shqetësimi i tij është ruajtja e integritetit të Komisionit të Venecias. Ashtu sikur u shpreh Monika Kryemadhi dje në Repolitix, edhe bashkëshorti i saj deklaroi se Komisioni i Venecias ka tejkaluar kompetencat me draftin që publikoi ku

thotë se Ilir Meta shkeli kushtetutën me anulimin e zgjedhjeve. "Unë mendoj se qëndrimi që do të bëhet publik nesër do të jetë një qëndrim zyrtar dhe do të ketë një letër timen si President i Republikës. Drejtuar Presidentit të Komisionit të Venecias dhe gjithë anëtarëve të Komisionit të Venecias me disa konsiderata për këtë draft paraprak. Do të ketë dhe disa pyetje që të ndihmohet më tej Komisioni i Venecias për shterimin e kësaj çështjeje dhe po kështu do të jetë i publikuar drafti i opinionit të Komisionit të Venecias dhe njëkohësisht dhe qëndrimi i Institucionit të Presidentit. Nuk kam asnjë shqetësim dhe asnjë frikë për Institucionin e Presidentit sepse jam shumë i qartë në të gjitha veprimet publike që kam bërë lidhur me çështjen në fjalë. Ato janë bërë përballë qytetarëve shqiptarë pikërisht këtu ku ne po flasim së bashku. I vetmi shqetësim i imi është të ruajmë integritetin e Komisionit të Venecias, pasi mendoj që kjo do të ishte e dobishme për vetë Komisionin. Komisioni i Venecias tejkaloi kompetencat. Në kushtetutën e Shqipërisë nuk ekziston termi tejkalim kompetencash", tha Meta.

Si do funksionojë policia vullnetare, detyrat dhe kriteret

Romina Kuko sqaron rolin e kësaj strukture të re: nuk janë spiunë lagjeje

Zv. e Brendshme, Romina Kuko ka dhënë detaje se si do të funksionojë policia vullnetare, duke theksuar se ato nuk janë "spiunë" siç disa e kanë etiketuar. Në një konferencë të posaçme për mediat, Kuko ka sqaruar se këta policë do të marrin pjesë në ngjarje të dinamikës së përditshme në komunitet dhe për ta thjeshtësuar këtë, zv.ministrja ka dhënë një shembull konkret.

"Nëse do marrin pjesë në një ndeshje futbolli, policët vullnetarë do të jenë krah efektivëve të policisë për t'i ndihmuar ato në futjen në stadium të policëve. Në rast të një aksidenti rrugor, ai nuk do të dublojë punën e policisë, por mund të kryejnë veprimet e para si lajmërimi i policisë apo të japë ndihmën e parë. Nuk do të marrin pjesë në aktivitete masive si protesta sepse për raste të tilla ka protokolle të veçanta. Mund të kryejnë veprimet e para, është një ndihmesë dhe angazhim vullnetar për të mirën e komunitetit", u shpreh Kuko.

Ky projekt është në fillesat e tij, për këtë arsye Kuko ka deklaruar se nuk ende një datë se kur do të marrë jetë apo numrin e kandidatëve që do të pranohet, megjithatë ka theksuar se do të jetë një kuotë e caktuar që do të varet nga numri i popullësisë dhe territori ku ato do të japin një shërbim. Duke u ndalur tek kushtet, që aplikanti duhet të plotësojë, Kuko ka sqaruar se nuk duhet të jetë i përjashtuar nga radhët e policisë dhe nëse është larguar, do t'i bëhet një "vetting" mbi motivet e largimit dhe pastërtinë e figurës së tij.

KRITERET

1. Kriteret e përgjithshme të pranimit të shtetasit në shërbimin e policimit vullnetar janë, si më poshtë vijon:

a) Të jetë shtetas shqiptar;

b) Të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar;

c) Të mos jetë i përjashtuar nga Policia e Shtetit apo i larguar nga administrata publike;

ç) Të ketë përfunduar arsimin e mesëm;

d) Të mos jetë i dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

dh) Të jetë i moshës nga 18 deri në 65 vjeç, në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën.

2. Kriteret e veçanta të pranimit të shtetasit në shërbimin e policimit vullnetar janë, si më poshtë vijon:

a) Të ketë përfunduar trajnimin e detyrueshëm me vlerësim pozitiv, si dhe të jetë i certifikuar nga Akademia e Sigurisë;

b) Të jetë i pajisur me vërtetimin e besueshmërisë.

PUNA QË DO BËJË

1. Shërbimi i policimit vullnetar funksionon në mbështetje të strukturave vendore të Policisë së Shtetit dhe bashkëpunon me këto të fundit me qëllim:

a) sigurimin dhe garantimin e rendit publik në aktivitetet me karakter masiv, si tubime, koncerte, festivale, aktivitete sportive dhe organizime fetare;

b) dhënien e ndihmës për menaxhimin e trafikut rrugor në qendrat urbane dhe rurale;

c) dhënien e ndihmës për rritjen e sigurisë publike pranë institucioneve arsimore;

ç) kontrollin e territorit, mbështetjen e patrullimit policor për parandalimin e krimit dhe ndërhyrjen ndaj shkeljeve të ligjit;

d) përballimin dhe menaxhimin e situatave të emergjencave civile, fatkeqësive natyrore, si dhe operacioneve të kërkim-shpëtimit me karakter masiv.

2. Polici vullnetar e kryen veprimtarinë e tij nën mbikëqyrjen e punonjësit të Policisë së Shtetit, i cili caktohet nga drejtuesi i strukturës vendore.

3. Kryerja e shërbimit të policimit vullnetar është i papajtueshëm me funksionet e gjyqtarit, prokurorit, përmbaruesit gjyqësor, drejtuesit në strukturat politike, punonjësit në institucionet e sigurisë kombëtare apo publike, të shërbimit të provës, të policisë së burgjeve dhe të Gardës së Republikës.

KËRKESA

U dënua për korrupsion, gjyqtari Miri do pas 30 mln lekët

Ish gjyqtari i Apelit në Tiranë, Shkëlqim Miri, është rikthyer në Gjykatën e Krimeve të Rënda, këtë herë për të kërkuar 30 milionë lekë që iu sekuestruara pasi përfundoi dënimin me 2 vite e 6 muaj burg. Sot në Gjykatë, Miri, në praninë e avokatit të tij Arben Prenga, kërkoi që 30 milion lekët t'i kthehen pasi janë para që sipas tij i ka marrë borxh për tu kuruar. Shkëlqim Miri u dënua nga Krimet e Rënda pasi u hetua si i përfshirë në korrupsion në dhënien e një vendimi drejtësie për të liruar Gentian Dodën. Prokurori Klodian Braho kërkoi gjatë hetimit që 30 milion lekët të konfiskohen me vendim gjykate në zbatim të ligjit Antimafia. Por vetë gjyqtari Miri këmbëngul që paratë ishin në banesën e tij pasi i kish marrë hua tek të afërm për tu kuruar jashtë vendit.

ISH-MINISTRI I BRENDSHËM

U dënua për shpërdorim detyre, Tahiri ankimon vendimin e gjykatës

Ish-ministri i Brendshëm Saimir Tahiri ka ankimuar në Gjykatën e Apelit të Krimeve të Rënda ankimin për vendimin ku u shpall fajtor me akuzën 'Shpërdorim Detyre'. Në komunikimin e parë për mediat pasi gjykata e dënoi për shpërdorim detyre duke i rrëzuar dy akuzat e prokurorisë për trafik droge dhe grup të strukturuar kriminal, ish-ministri tha se sapo të dalë vendimi i zbardhur i Gjykatës, do ta apelojë atë për të çuar deri në fund betejën e tij të drejtësisë. Ndaj Tahirit ranë të gjitha akuzat për trafik droge në bashkëpunim dhe grup të strukturuar kriminal mbi të cilat Prokuroria kërkoi që ish-ministri i Punëve të Brendshmë të dënohej me 12 vite heqje lirie. Pas dy vite hetime, nga nëntori i 2017-ës, Gjykata për Krime të Rënda rrëzoi të gjitha akuzat e ngritura ndaj ish-ministrit të Punëve të Brendshme, Saimir Tahiri duke e dënuar vetëm për shpërdorim detyre, një vendim prej të cilit, ai nuk do të bëjë asnjë ditë burg! Gjykata e dënoi Tahirin me 5 vite burg për këtë akuzë të re që në gjuhën juridike quhet, kualifikim i veprës penale: Shpërdorim të detyrës. Por me gjykim të shkurtuar dënimi ulet në 3.4 vite burgim. Edhe këtë dënim, gjykata vendosi ta konvertojë në 3 vite shërbim prove, periudhë në të cilën ish-ministri nuk duhet të kryejë asnjë vepër penale. Po ashtu, për 3 vite, ish-ministri Tahiri nuk duhet të ushtrojë funksione publike.

VJEDHJA E INSTITUCIONIT

Hajdutët futen 2 herë te parku i automjeteve të Ministrisë

Në më pak se një javë Parku i Automjeteve në varësi të Ministrisë së Brendshme në zonën e "Rrugës së Kavajës" ka rënë pre e vjedhjeve me autorë ende të paidentifikuar. Në këtë park, Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Policinë e Shtetit ka konstatuar mungesën e disa pjesëve të kondicionerëve, disa pjesëve të pajisjeve elektronike të nxjerra jashtë përdorimit dhe disa pjesë automjetesh. Pas këtij konstatimi kanë nisur hetimet duke referuar materialin në prokurori, ndërsa dyshimet se në vjedhje mund të jenë përfshirë dhe policë kanë bërë që SHÇBA të angazhohet në këtë hetim. Materialet e vjedhura janë të nxjerra jashtë përdorimit pas rikonstruksionit të Ministrisë së Brendshme dhe janë vendosur në Park pasi janë në procedurë të ankandit për tu kaluar për skrap.

Pas publikimit të lajmit ka reaguar edhe Policia e Tiranës e cila ka në ruajtje këtë objekt. "Në rrugën e "Kavajës", persona ende të paidentifikuar kanë vjedhur në magazinën e Qendrës së Shërbimeve të Automjeteve të Transportit, në varësi të Ministrisë së Brendshme, disa pajisje elektronike të dala jashtë përdorimit, të cilat ishin për tu asgjësuar. Po punohet për identifikimin dhe kapjen e autorëve. Materialet janë referuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprën penale "Vjedhja" .

BAILIFF OFFICERS

Zyra Përmbarimore Private "BAILIFF OFFICERS" sh.p.k, me adresë: Rr "Kavajës" pranë qëndrës "Globe" Nd 124, Hyrja 8, Kati 2, Tiranë, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, njofton se do të kryej procedurat për shitjen në ankand-3, të pasurisë të paluajtshme, lënë garanci për Bankën "Credins" si më poshtë,

- **NË DATË 14.10.2019 ORA 16:30**

-Pasuri nr. 207/33, ZK 1685, lloji i pasurisë (trual+ndertese) me sip. 500 m2, me adresë Gajush, Lezhë, në pronësi të z.Pjeter Pergjoka, me çmimi fillestar 1,512,000 lekë.

Për informacione mund të kontaktoni në numrin e Cel: +355 692044540 ose adresën e-mail: ilirdervishi85@gmail.com

INVESTIMET PUBLIKE

Buxheti afatmesëm, ja rrugët që do të financohen deri në 2022

Shifrat më të larta investohen në Kardhiq-Delvinë dhe Qukës-Qafë Plloçë

Genc Kondi
TIRANE

Përveç ndërtimeve madhore të segmenteve rrugore me anë të koncesioneve të Partneritetit Publik-Privat, edhe vetë shteti ka parashikuar të investojë direkt në disa nga rrugët nacionale në ndërtim gjatë periudhës që përfshihet në buxhetin afatmesëm, deri në vitin 2022. Nga buxheti i shtetit do të jepen miliarda lekë për të vijuar kryesisht segmente të cilat kanë filluar më parë, por që duan kohë të mbarojnë. Sipas buxhetit, qeveria parashikon që kantieret shtetërore të përfundojnë projektet e filluara në vitin 2021, që është edhe vit elektoral, gjatë të cilit do të zhvillohen zgjedhjet parlamentare.

Në radhë të parë, këtë vit dhe vitin e ardhshëm do të kanalizohen fonde të konsiderueshme në projektin e jugut, që shkurton rrugën nga

veriu drejt Sarandës. Tre lote të rrugës Kardhiq-Delvinë do të përfitojnë nga rreth 500 milionë lekë seicili këtë vit, por shifrat do të kalojnë në më shumë se një miliard lekë për secilin vitin e ardhshëm. Në buxhet përfshihet edhe loti 7, që përmban edhe ndërtimin e një tuneli, i cili e përfundon segmentin, por që kohët e fundit ka hasur në probleme me procedurat e tenderimit, duke qenë se ankesat e subjekteve pjesëmarrës kanë kthyer procesin nga e para. Për këtë lot të fundit parashikohen 560 milionë lekë këtë vit dhe 2.3 miliardë lekë vitin e ardhshëm. Duke qenë se nuk parashikohet fond për vitin 2021, duket se qeveria parashikon që ta mbyllë gjithë rrugën vitin e ardhshëm.

Unaza e Madhe e Tiranës është fronti tjetër që do të marrë fonde të konsiderueshme në kuadër të ndërtimit të rrugëve. Këtu punimet do të përqendrohen në pjesën perëndimore, ku ecuria pengohet nga protestat e banorëve të "Astirit", si dhe nga bllokimi i tenderit për lotin tek sheshi "Shqiponja", por do të përfshijnë edhe pjesën lindore, nga kthesa e Saukut deri tek Bregu i Lumit. Edhe këtu do të jepen më shumë financime vitin e ardhshëm, se këtë vit, me synimin që këto lote të përfundojnë kryesisht në vitin 2020, me përjashtim të lotit të "Shqiponjës" që mendohet të mbarijë në fund të 2021-shit.

Tjetër segment që do të marrë vëmendje, është ai i filluar që prej më shumë se gjashtë vjetësh, por të cilit iu ndryshua projekti. Fjala është për rrugën nga Qukësi në Qafë Plloçë, që shkurton shumë rrugën drejt Korëçës dhe Greqisë. Kjo vepër ndërtohet me financimin e disa investitorëve të huaj shtetërore ose nga organizata ndërkombëtare dhe gjithashtu parashikohet të mbarojë në fund të vitit 2020.

Një vepër e re është parashikuar në afërsi të TEG-ut në Tiranë, që do të konkretizohet në një mbikalim me kosto 1.6 miliardë lekë gjatë vitit të ardhshëm, sëbashku me ndërtimin e By Pass-it të Elbasanit, që shmang trafikun e rënduar brenda qytetit. Ky u fundit do të financohet në vitet 2020-2022. Projekte të tjera janë rruga Krujë-Fushë Krujë, Skrapar-Përmet Loti 1, Elbasan-Banjë Loti 3, By Passi i Shkodrës, ai i Tepelenës, etj.

Të gjitha këto projekte nuk kanë të bëjnë me grupin e investimeve me koncesion, si Rruga e Arbërit, Rruga e Kombit, etj.

PRIORITETET NË INVESTIMET TEK RRUGËT NACIONALE SIPAS BUXHETIT AFATMESËM

SEGMENTI	VITI 2019	VITI 2020	VITI 2021	VITI 2022
Kardhiq-Delvinë Loti 4	538 mln	1.7 mld		
Kardhiq-Delvinë Loti 5	409 mln	1.3 mld		
Kardhiq-Delvinë Loti 6	542 mln	1.8 mld		
Kardhiq-Delvinë Loti 7	560 mln	2.3 mld		
Nyja Milot + rrugë dytësore	294 mln	835 mln		
Mbikalime Thumanë-Milot; Kukës-Morinë	83 mln	264 mln		
By Pass Shkodër Loti 1	10 mln	559 mln		
By Pass Shkodër Loti 2	10 mln	293 mln		
Unaza e Madhe Tiranë, lindje Loti 1	670 mln	50 mln		
Unaza e Madhe Tiranë, lindje Loti 2	71 mln	1.8 mld		
Unaza e Madhe Tiranë, lindje Loti 3	190 mln	356 mln		
Unaza e Madhe Tiranë, perëndim Loti 1	539 mln	1.1 mld	1.1 mld	
Unaza e Madhe Tiranë, perëndim Loti 2	358 mln	1.5 mld		
Unaza e Madhe Tiranë, perëndim Loti 3	267 mln	1.2 mld		
Skrapar-Përmet Loti 1	3 mln	130 mln		
By Pass Tepelenë	545 mln	1.7 mld		
Elbasan-Banjë Loti 3	78 mln	243 mln		
Krujë-Fushë Krujë	-	1 mld		
Mbikalimi TEG	-	1.6 mld		
Qukës-Qafë Plloçë Loti 1	600 mln	1.6 mld		
Qukës-Qafë Plloçë Loti 2	706 mln	3.1 mld		
Qukës-Qafë Plloçë Loti 3	597 mln	2.6 mld		
By Pass Elbasan	-	50 mln	500 mln	500 mln

Detajet

RISITË
Një vepër e re është parashikuar në afërsi të TEG-ut në Tiranë, që do të konkretizohet në një mbikalim me kosto 1.6 miliardë lekë gjatë vitit të ardhshëm, sëbashku me ndërtimin e By Pass-it të Elbasanit

ZGJEDHJET
Sipas buxhetit, qeveria parashikon që kantieret shtetërore të përfundojnë projektet e filluara në vitin 2021, që është edhe vit elektoral, gjatë të cilit do të zhvillohen zgjedhjet parlamentare

VALUTAT

Euro rifiton terren ndaj lekut, tani në nivelin 122.66

Monedha e përbashkët ka hyrë në një trajektore rritëse në tregun e brendshëm prej më shumë se dy javësh. Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë një euro u këmbye dje me 122.66 lekë, duke u arritur në nivelin më të lartë që nga fundi i muajit maj.

Që nga mesi i shtatorit, kur arriti në 121.5 lekë, monedha e përbashkët është mbiçmuar me 1.5 lekë, në tendencë të ndryshme nga bursat ndërkombëtare ku euro ka qenë e dobët. Aktorët e tregut valutor pohojnë se rritja e euros lidhet më shumë me faktorë të tregut të brendshëm, ku bankat e nivelit të dytë kanë qenë aktive në blerje gjatë ditëve të fundit, për llogari të klientëve të tyre. Nga ana tjetër edhe faktorët sezonalë që nxitën rënien e euros në gusht, si prurjet nga turistët dhe nga emigrantët kanë përfunduar, duke ndikuar në uljen e ofertës. Në të kundërt, dollari ka rënë në tregun e brendshëm, pasi pardje arriti në 122.15 lekë, niveli më i lartë ky që prej fundit të 2017-s. Ekspertët presin që euro të jetë e fortë deri në muajin dhjetor dhe më pas sezonalisht fundi i dhjetorit shënon një nënçmim të saj, për shkak të prurjeve të emigrantëve. Aktorët presin që në periudhat në vijim volumet e këmbimit do të jenë tepërt të ulëta. Sipas tyre muaji tetor dhe gjysma e muajit nëntor, historikisht, janë konsideruar si muaj të vdekur për sa i përket volumeve tregtare dhe parasë në qarkullim.

Cyan magenta yellow black



Venecia dorëzon draftin e analizës për p/ligjin e ri për tokat

Kritika të shumta për hartuesit: Ligj i paqartë dhe i pasaktë, të ndryshohet

Projektligji

Projektligji për procedurat kalimtare të pronësisë është hartuar në nëntor të vitit të kaluar dhe u bllokua në Kuvend. Në finale, ky draft synon që brenda një afati të caktuar të regjistrojë të gjitha pronat e paregjistruara në republikën e Shqipërisë

Komisioni i Venecias ka bërë kritika të shumta për projektligjin e Qeverisë përsa u përket tokave bujqësore dhe titujve të pronësis, dhënë nëpërmjet AMTP-ve, duke i sugjeruar Kuvendit që t'i bëjë draftit korigjime. Mes vërejtjeve kryesore janë edhe paqartësia dhe hapësira rregulluese që p/ligji i lejon Qeverisë.

VLERËSIMI

"P/ligjit në versionin e tij aktual i mungon qartësia dhe saktësia për shkak të mungesës së përkufizimeve dhe fuqisë rregulluese shumë të gjerë për Këshillin e Ministrave, mungesës së hapave themelorë procedurialë dhe afateve të përcaktuara qartë për mbajtësit e titujve", theksohet në draft. Opinioni i Venecias që ka qenë në Tiranë ishte kërkuar nga kryeparlamentari Ruçi pas diskutimeve të forta që krijoi drafti i prezantuar nga Qeveria. Kuvendi kërkonte veçanërisht mendim nëse nenet 7 dhe 9 binin ndesh me të drejtat e njeriut dhe pikërisht këtu ekspertët e Venecias evidentojnë probleme. "Ekziston një rrezik i lartë që p/ligji të mund të krijojë probleme pajtueshmërie me nenin 1 të Protokollit të Parë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe dispozita të tjera, si dhe me Kushtetutën shqiptare. Në veçanti, Nenet 7 dhe 9 të p/ligjit janë në thelb të paqarta dhe të pasakta, prandaj mbajnë një rrezik të lartë që zbatimi i tyre do të çojë në shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut", thekson drafti. Konstatohet një përplasje që projektligji mund të sjellë me të drejtën që kanë institucionet për anulimin e titujve të pronësisë për tokat bujqësore, të dhëna nga Aktet e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP), theksojnë ekspertët e Venecias. "Të përcaktohen në p/ligj rregullat për paraqitjen e provave, aksesin në prova dhe të drejtën për t'u dëgjuar para vendimit të autoriteteve për të shpallur të pavlefshëm AMTP", thuhet në rekomandimet e Venecias. Anëtarët e delegacionit krijuan përshtypjen se, edhe pse kthimi në natyrë (i tokës në pronësi të mëparshme) është parashikuar në ligj, sipas këtij raporti, edhe kur ka qenë e mundur, institucionet përgjegjëse do të zgjidhnin më shumë opsionin e kompensimit, duke mbajtur shpesh tokën në dispozicion si pronë e shtetit për t'u përdorur për programet shtetërore. Për këto arsye Komisioni fton ligjvënësit shqiptarë të rishikojnë draftin dhe ofrojnë disa rekomandime. Sipas mendimit të Komisionit të Venecias, do të ishte e dobishme nëse autoritetet do të kryenin studime të hollësishme mbi shkaqet e mangësive të kornizës aktuale legjislative, ndoshta me ndihmën e ekspertizës ndërkombëtare dhe të vlerësojnë ndikimin në aspektin e buxhetit dhe burimeve njerëzore të këtij projektligji. Për të kërkuar mbështetje specifike praktike, në kuadrin e veprimeve tashmë ekzistuese të Këshillit të Evropës, aktivitetet e bashkëpunimit do të këshillohen për hartimin e legjislacionit, si dhe për zbatimin. Për këtë vetë Venecia ofron ndihmën me ekspertët e saj ligjorë.

KOMPENSIMET

Ndër të tjera ekspertët e Venecias kanë theksuar se ende janë të shpeshta problemet me kompensimin e pronave, pavarësisht se legjislacionet janë ndryshuar disa herë. "Ligji Nr. 7698/1993 "Për kthimin dhe kompensimin e ish-pronarëve" filloi procesin e kthimit dhe kompensimit për pronarët origjinal të shpronësuar gjatë regjimi komunist. Deri më tani, ky proces mbetet jo i plotë, dhe rezulton se në disa raste se titulli i tokës dhe pronësia aktuale e tij, dhe çdo ndërtesë e ngritur mbi të ndryshon. Për më tepër, mbivendosja e titujve bujqësorë pjesërisht ose në tërësi është një problem i shpeshtë".Gjatë takimeve në Tiranë, Komisioni thekson se është vënë në dijeni edhe mbi problemet e zbatimit të ligjit të vitit 2015 për kthimin dhe kompensimin e pronave. "Anëtarët e delegacionit krijuan përshtypjen se edhe pse kthimi në natyrë (i tokës në pronësi të mëparshme) është parashikuar në ligj, edhe kur ka qenë e mundur, institucionet përgjegjëse do të zgjedhnin më shumë opsionin e kompensimit, duke mbajtur shpesh tokën në dispozicion si pronë e shtetit për t'u përdorur për programet shtetërore".

KONKLUZIONET

Oponioni në fjalë pritet të miratohet nga Komisioni i Venecias në sesionin plenar të 11 tetorit.

Ndërkohë, Venecia ka kërkuar nga qeveria që të rishikojë këtë projektligj dhe të bëhen ndryshimet e nevojshme në mënyrë që ai të jetë i saktë dhe i qartë. Projektligji për procedurat kalimtare të pronësisë është hartuar në nëntor të vitit të kaluar dhe u bllokua në Kuvend. Në finale, ky draft synon që brenda një afati të caktuar të regjistrojë të gjitha pronat e paregjistruara në republikën e Shqipërisë.

REKOMANDIMET E KOMISIONIT TË VENECIAS

- Përcaktoni natyrën deklaruese të aktit të regjistrimit të titujve, veçanërisht AMTP, në projektligj.
- Të rishikojë nenet 7 dhe 9 dhe artikujt në lidhje me to, duke marrë parasysh që titujt bujqësorë në formën e AMTP si dhe përdorimi i vazhdueshëm i tokës me shpresën e ligjshme për t'u pajisur me AMTP përbëjnë pronë të mbrojtur sipas nenit 1 të protokollit 1 të KEDNJ.
- Të përcaktojë në vetë p/ligjin mangësitë që parandalojnë vërtetimin e AMTP-ve, si dhe të kufizojë hapësirat rregulluese në dispozion të Këshillit të Ministrave në nivelin strikt të domosdoshëm.
- Të parashikohen në p/ligj afate të sakta për mbajtësit e titujve dhe hapat themelorë procedural, veçanërisht kur lidhen me transferimin e titujve të pronave bujqësore.
- Të përfshijnë në p/ligj përcaktimet thelbësore për titujt e pronave bujqësore.
- Të përcaktohen në p/ligj rregullat për paraqitjen e provave, aksesin në prova dhe të drejtën për t'u dëgjuar para vendimit të autoriteteve për të shpallur të pavlefshëm AMTP.
- Të zhvillohen konsultime publike me të gjitha palët e interesuara.

Paraja

Banka qendrore: Nivel shumë i lartë i parasë 'cash" në Shqipëri

Paraja që qarkullon jashtë sistemit bankar arriti në gusht në një nivel rekord prej 288 miliardë lekësh, ose 2.3 miliardë euro, sipas Bankës së Shqiprisë. Ky është niveli më i lartë i regjistruar ndonjëherë në vlerë absolute, që prej vitit 2002, kur raportohen të dhënat. Kjo shumë, sipas statistikave të Bankës së Shqipërisë është e barabartë me 22.2% të parasë gjithsej, më e larta që nga fundi i vitit 2009, kohë kur kishte një valë tërheqje depozitash për shkak të panikut që u krijua nga kriza globale financiare.

Pasi ra në periudhën 2010-2014, paraja jashtë bankave filloi të rritej sërish në 2015-n, sidomos nga gjysma e dytë e 2016-s, duke vijuar këtë tendencë edhe aktualisht, në një tregues të informalitetit të lartë, por dhe hyrjes së parave nga kanale jo zyrtare.

Në krahasim me vendet e Eurozonës, apo edhe të rajonit, Shqipëria ka një nivel tepër të lartë të parasë që qarkullon jashtë kanaleve bankare. Në Eurozonë, sipas të dhënave nga Banka Qendrore Europiane, niveli i parasë jashtë bankave ishte rreth 9.2% e totalit. Në Maqedoni, ky tregues, sipas të dhënave të Bankës Qendrore përkatëse, ishte rreth 7-8%. Edhe në Serbi ishte rreth 7% e totalit.

STRATI
BAILIFF SERVICE

Shoqëria përmbarimore **"STRATI BAILIFF'S SERVICE" Sh.p.k.,** njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurisë së paluajtshme: "Apartament" me sipërfaqe totale 77.31 m², me vendndodhje Rr. "Reshit Petrela", Tiranë, në pronësi të Dëshira Sinani, regjistruar në Zyrën e Pasurive të Paluajtshme Tiranë, me Nr. Pasurie Nr. 7/168+2-20/1 dhe me Nr. Regjistri Hipotekor 259 date 21.10.2009, Zona Kadastrale 8330, Volumi 15 Faqe 209, lënë si garanci bankës me kontratën e hipotekës Nr. 2265 Rep Nr. 979 Kol datë 10.05.2011. Çmimi fillestar i ankandit është 31,248 Euro.

ANKANDI PËR PASURITË E MËSIPËRME ZHVILLOHET NË DATË 10.10.2019.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambjentet e Zyrës Përmbarimore Private "Strati" sh.p.k., Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7. Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

SHPALLJE ANKANDI II

Zyra permbarimore, me permbaruese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e dyte për pasurine :

1- "Njesi", me sipërfaqe totale 33 m2 ,e ndodhur në Durres , në Zonën Kadastrale: 85/13 , Numri i Pasurisë: 2/374-N5, Vol. 48, Faqe. 229, ne pronesi te Sherif Mahmut Shquti . Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën e 1,219,680 (nje milion e dyqind e nentembedhjet mije e gjashteqind e tetedhjet) . LEKË

Ankandi i dyte per pasurine e mesiperme zhvillohet me datë 25.10.2019 , ora 16:00 në ambientet e Zyrës se permbaruese gjyqesore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr."Myslym Shyri, vila nr.8/1,kt.4,Tiranë, nr.kontakti 04 222 9114 .

Babai i dy fëmijëve parandjeu fundin, njoftoi policinë për rrezikun që po i vinte

Besmir Hida, një javë më parë denoncoi se persona të dyshimtë po përgatisnin vrasje

Besmir Hida

Besmir Hida 40 vjeç, baba i dy fëmijëve u ekzekutua dy ditë më parë në qendër të qytetit të Lushnjes teksa ishte duke pirë kafen në katin e dytë të një lokali. Autorët e dyshuar të vrasjes janë Laert Haxhiu dhe Orgest Bilbili. Hida ishte në dijeni të rrezikut. Madje hera e fundit që kishte shkuar në polici për të denoncuar lëvizjen e lirë në qytet të dy autorëve të vrasjes së nipit të tij kishte qenë rreth një javë para se të ekzekutohej. Pavarësisht denoncimeve dhe pamjeve në polici të autorëve që lëvizin të lirë, por dhe rrezikut që mund t'i vinte nga një fakt i tillë nuk u mor asnjë masë dhe në 1 tetor ai u ekzekutua. Ndaj Hidës ishte bërë edhe një atentat i mëparshëm, duke i vendosur tritol makinës të tij, por kishte shpëtuar mrekullisht. Besmir Hida, tregtar makinash, është daja i Zamir Latifit, të riut që u vra aksidentalisht në 11 tetor të vitit 2017 në Lushnje, teksa shënjestër ishte Xhulio Shkurti, nipi i Aldo Bares. Në këtë ngjarje fshihet e njëjta dorë vrasësish që për 3 vite me radhë mban në terror qytetin e Lushnjes. "Një grup i strukturuar kriminal me lidhje shumë të forta që mban nën kontroll me dorë të hekurt qytetin agro-bujqësor më të rëndësishëm në vend", thotë gazetari. Vrasësit me maska përdorën një makinë të cilën ia kishin grabitur një çiftit mbrëmjen e së martës tek "Casa Italia".

BESMIR HIDA KËRKONTE DREJTËSI

Besmir Hida, ishte një person i cili vijonte të kërkonte drejtësi për vrasjen e nipit të tij, para se ta ekzekutonin këtë 1 tetor, i kanë vendosur eksploziv në banesë që të largohej bashkë me familjen jashtë vendit. Këtë moment kanë shfrytëzuar autorët, të cilët të maskuar, kanë zbritur nga një automjet janë ngjitur në katin e dytë të lokalit, dhe e kanë ekzekutuar 40-vjeçarin me kallashnikov. Pas atentatit, autorët janë larguar me një automjet tip "Seat" që u gjet u djegur në dalje të lagjes "18 Tetori". Mësohet se makina ishte vjedhur mbrëmjen e së martës në zonën e Unazës së Re në kryeqytet. Në 2017-ën ishin Laert Haxhiu dhe Orgest Bilbili ata autorë të vrasjes së Zamir Latifit dhe Jurgen Hoxhës, ndërsa mbeti i plagosur Marius Xhepexhiu, pronari i lokalit ku ndodheshin dy të rinjtë. E njëjta skemë edhe aty u qëllua me breshëri plumbash teksa viktimat konsumonin kafe. Latifi dhe Hoxha u vranë aksidentalisht, pasi shënjestër ishte Xhulio Shkurti, nipi i Aldo Bares. Ai është tentuar të vritet më 25 shtator 2016, ngjarje për të cilën ka qenë në kërkim Laert Haxhiu, i dënuar me 24 vite burg në mungesë.

NGJARJA

Zbulohet fotoja personave të arrestuar për trafikimin e 617 kg kokainë me vulën e "K.F. Elbasani"

Zbulohen detaje të reja nga droga e kapur në Brazil. Është zbuluar identiteti i katër personave të arrestuar në datën 1 tetor, pasi iu gjetën 617 kg kokainë teksa po udhëtonin me kamion, ku destinacioni i tyre dyshohet të ishte Shqipëria. Ata janë: P. O. O. C. 24 vjeç; M. A. P. 49 vjeç; N. P. 52 vjeç dhe J. C. G. A. 40 vjeç. Lidhja e drogës së kapur në Brazil me Shqipërinë është se mbi të ishte vulosur 'K.F. Elbasani', klubi i një prej skuadrave të futbollit të vendit tonë. Gjithashtu nisur nga inicialet, njëri nga personat e arrestuar N. P. 52 vjeç mund të jetë shqiptar, pasi vetëm ai ka iniciale të shkurtra dhe emrat e Amerikës Latine në përgjithësi janë shumë të gjatë. Në kamionin e bardhë Mercedes Bens 1620 me targa të Pontes Lacerda CVN3518, u gjet sasia e 617 kg kokainë, që kishin të vulosur K.F. Elbasani. Sipas medias së huaj, kamioni ishte nën shënjestër të policisë pasi disa persona ishin ankuar më parë. Personat e arrestuar, pronën e kishin kthyer në një rafineri të ambalazhimit të kokainës. Në pronën që ndodhej në Gleba Tibaji afër Brasnorte u gjet një sasi e madhe e lëndëve narkotike dhe materiale të ndryshme për mbështjellja e vendosjen e drogës. Përvec 617 kg drogë, policia sekuestroi edhe disa tableta të substancës hidroklorur kokainë dhe 2 tableta të një lënde të pastës së kokainës. Policia sekuesteroi kamionin e mallrave tip Mercedes 1620 me targa CVN3518, një fiat të bardhë me targa NDH7227 dhe një fiat me ngjyrë argjendi me targa NJU9234.

VENDIMI

Apeli rrëzon ankimimin e Tatimeve,lë në fuqi "pafajësinë e biznesmenit Rezart Taçi

Ish-biznesmeni i hidrokarbureve në Shqipëri, Rezar Taçi, arrin fitoren e radhës përballë institucioneve shtetërore si Drejtoria e Tatimeve dhe Prokuroria e Tiranës. Pas pafajësisë së marrë në shkallën e parë ku ai ishte në akuzë për evazion fiskal me 7 miliard lekë e mospagim taksash, një ditë më parë edhe Apeli i Tiranës i ka dhënë atij të drejtë. Duke lënë në fuqi pafajësinë, Apeli ka rrëzuar ankimin e prokurorisë e cila kërkoi dënimin e Taçit pas kallëzimit të depozituar nga Drejtoria Tatimore. Taçi prej disa kohësh ka lënë Shqipërinë ndërsa përball institucioneve ai ka fituar disa herë pafajësi dhe pse ndaj tij ka pasur akuza të rënda për evazion fiskal.

OPERACIONI NË GREQI

Droga me gomone,Mediat greke 2.5 ton marijuanë e ngarkuar në Vlorë, do këmbehej me heroinë

Detaje të reja kanë dalë në dritë nga operacioni i policisë greke i disa ditëve më parë, ku u gjetën në një shpellë më shumë se 1 ton kanabis. Referuar mediave greke, dy gomonet e kapura ishin ngarkuar në Vlorë me 2.5 ton marijuanë dhe si destinacion kishin Aivalin, Turqi. Arsyeja se përse zgjidhej Turqia ka të bëjë me tregun fitimprurës pasi kostoja për kg aty kap vlerën 3-4 mijë euro, e ndërsa në Greqi 1 mijë euro. Sipas mediave, droga do të shkëmbehej me 150 kg heroinë, ku një sasi prej 1.3 ton ishte lënë në brigjet turke dhe 102 të tjera u kapën nga policia greke. Gjatë operacionit të ndjekjes, mësohet se trafikantët e shtirur si "klandestinë" kanë hedhur heroinën në det, në një thellësi që shkon deri në 3000 metra. Operacioni i policisë greke ka zgjatur 5 ditë, nga ku u zbulua 1 ton e 172 kg marijuanë në ishullin Piperi, të ndarë në 106 pako. Gjithçka ka nisur në datën 25 shtator ku u pikas një gomone me drogë në brigjet e Turqisë. Për kapjen e saj, u angazhuan 10 skafe, 1 helikopter dhe 1 avion si dhe 2 avionë të FRONTEX në verilindje të detit Egje, në fund të së cilit u arrestuar 3 persona, ku sipas mediave greke janë dy shqiptarë dhe një italian, përkatësisht të moshës 25, 42 dhe 42-vjeç. Megjithatë, policia greke nuk ka dhënë zyrtarisht detaje lidhur me origjinën e të arrestuarve, por më herët është konfirmuar nga ajo shqiptare, ndonëse këta të fundin nuk e konfirmuan se u është gjetur drogë.

VRASJA E ISH-POLICIT

Santiago paditi policinë pse e shpalli në kërkim për plagosje

Malko kur ishte në kërkim, 1 muaj para vrasjes i hapi gjyq policisë së shtetit



ELTON QYNO
TIRANE

Santiago Malko, personi që u ekzekutua me 9 plumba mbrëmjen e 27 gushtit 2019, në zonën e Porcelanit në Tiranë, ishte shpallur në kërkim policor për një periudhë prej katër mujore, pasi ishte personi kryesor që dyshohej për plagosjen e rëndë të dy vëllezërve Mumajesi në Tiranë. Malko ka qenë në kërkim por çuditërisht askush nuk e ka ndaluar në kryeqytet, duke e lënë të lirë edhe pse ai nuk i fshihej drejtësisë apo policisë. Santjago Malko, rezulton se është vënë në dijeni sipas një lajmi që ka qarkulluar ne median audio vizive, se ai ishte shpallur në kërkim. Duke qenë se në lidhje me këtë lajm Santiago Malko, nuk ka marrë ndonjë njoftim zyrtar i është drejtuar me 5 kërkesa Drejtorisë së Policisë Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë,ku në thelb ka kërkuar informacion nëse ky lajm i mediave ishte i vërtete pasi në asnjë moment nuk ka kryer ndonjë veprim të kundraligjshëm për tu bërë objekt kërkimi apo njoftimi në Pikat e Kalimit Kufitar dhe për me tepër në asnjë rast nuk i ishte shmangur organeve ligjëzbatuese. Sipas materialit që ndodhet në gjykatën Administrative të Tiranës, rezulton se Departamenti i Policisë Kriminale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, thotë se Santjago Malko, është shpallur në kërkim policor më datë 31 dhjetor 2018 nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, në kuadër të proçedimit penal nr.5113 të vitit 2018 dhe më datë 5 prill 2019, është anulluar nga kërkimi për kalim afati kërkimi policor. Por nëpërmjet lidhjeve të veta në polici, në rrugë konfidenciale Santiago Malko ka mësuar se ndaj tij rezulton në sistemin TIMS një "njoftim në kufi". Ka rezultuar se Santjago Malko, ka kërkuar informacion Drejtorisë së Policisë Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, nëse për të ekziston njoftim në kufi dhe nëse cila është arsyeja që ai rezulton në sistem TIMS me njoftim, si dhe fshirjen apo anulimin e njoftimit në kufi. Edhe pas disa pesë kërkesash zyrtare nëpërmjet shërbimit postar nga ana e këtyre organeve administrative, nuk është kthyer asnjë informacion zyrtar. Më tej Santiago Malko në 8 maj 2019 rezulton të ketë marrë një vërtetim në prokurorinë e Tiranës, ku thuhej se prokuroria s'ka nisur asnjë procedim penal kundër tij për plagosjen e kryer në Tiranë. Nisur nga kjo situatë ai në muajin korrik 2019 ka depozituar padinë në gjykatën administrative Tiranë duke hapur një betejë ligjore me policinë dhe kërkuar në gjykatë, detyrimin e policisë që ti hiqte emrin nga sistemi i kërkimit kufitar në TIMS. Por vetëm një muaj pas kësaj padie, Santiago Malko është vrarë me 9 plumba nga klani "Duka" i përbërë nga Leonard dhe Elis Duka, Oltian Loka, Ilir Selmani,Fatmir Hyseni, Bledar Teta dhe Aleksandër Maxhaku, Dritan Agaj ose "Gabeli". Por Malko, jo vetëm që nuk është arrestuar, por Malko ka pasur kohën e mjaftueshme për tu impenjuar dhe në një proces gjyqësor në gjykatën Administrative të Tiranës, ku kishte paditur Drejtorinë e Policisë Tiranë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Padia në sekretarinë e gjykatës është dorëzuar nga Malko vetëm një muaj para se ai të ekzekutohej, pasi rezulton se në 9 korrik 2019 ai ka paraqitur padinë kundër Policisë së Shtetit dhe Policisë së Tiranës dhe çështja ishte marrë në shqyrtim nga gjyqtari Semiramis Hoxholli. Konflikti gjyqësor mes Policisë dhe Santiago Malko kishte të bënte me anulimin e një akti administrativ të nxjerrë nga Policia e Tiranës, e cila kishte urdhëruar një masë pengimi në kufi të Malkos, duke vendosur në sistemin TIMS shënimin "njoftim në kufi". "Shqiptarja.com" mëson se përpara kësaj mase, ka rezultuar se Santiago Malko, ka qenë në kërkim policor nga policia e Tiranës, për ngjarjen e datës 27 qershorit të vitit 2018, ku mbetën të plagosur dy vëllezërit Rivelino dhe Juxhin Mumajesi, dhe një person tjetër i quajtur Ibrahim Durollari.

ZBARDHEN LETRAT / I RIU NUK KA QËNË NË SHQIPËRI NË MOMENTIN KUR KA NDODHUR VRASJA

Xhoni Nica i akuzuar si pjesë e grupit "Duka", ishte në Itali

Ekzekutimi me eskortë të hapur dhe në mes të njerëzve në Tiranë, i ish-efektivit të policisë së Tiranës Santiago Malko nga klani "Duka", dyshohet se është kryer nga një killer me pagesë nga Vlora, i quajtur Fatmir Hyseni, ish-kunati i "Didit të Vlorës". Hyseni në këtë vrasje, sipas policisë ka bashkëpunuar ngushtë me vëllezërit sponsorizues Leonard dhe Elis Duka dhe personat e tjerë si Oltian Loka, Ilir Selmani, Bledar Teta dhe Aleksandër Maxhaku, Dritan Agaj ose "Gabeli" dhe Xhoni Nica. Për të gjithë këta persona prokuroria e Krimeve të Rënda që nga momenti kur ka marë dosjen, ka nisur verifikimet duke zbuluar dhe vendodhjen e peresonave të akuzuar. Sipas burimeve, Xhoni Nica i përfshirë nga policia në këtë ngjarje, rezulton të ketë qënë jashtë shtetit, ditën kur ka ndodhur ekzekutimi i Santiago Malkos. Nuk dihet se në çfarë rrethana është futur dhe çfarë roli ka pasur Xhoni Nica në këtë ngjarje, por burime pranë prokurorisë bënë me dije se djaloshi, ka qënë në itali. Nga verifikimi në sistemin TIMS që prokuroria ka bërë për këtë person, ka rezultuar se Xhoni Nica, është larguar nga Shqipëria 27 ditë para vrasjes së Santiago Malkos, mikur të Ervis Martinaj. Sipas sitemit Tims, Nica kla udhëtuar nga pika kufitare e Morinës, duke hyrë në Kosovë dhe mandej nga Aeroporti i Prishtinës, ka udhëtuar drejt Italisë, duke zbritur në Verona. Në ditët para ngjarjes por dhe ditën e krimit të vrasjes së Santiagos, Xhoni Nica, nuk ka qënë fare në Shqipëri. I riu ka udhëtuar në drejtim të Italisë, shtet ku besohet se do të qëndrojë dhe të punojë në vazhdim. Pritet që në ditët në vijim Prokuroria e Krimeve të Rënda të marë një vendim për nxjerjen ose jo nga arresti në burg në mungesë.

NDRYSHIMI I AKUZËS

Nga moskallëzim krimi, në vrasës, akuza e re për Bledi Tetën

Shkon në nëntë numri i të dyshuarve si pjesë e grupit kriminal në hetim nga Krimet e Rënda për vrasjen e ish-policit Santiago Malko. Pas të dyshuarve shpallur në kërkim, Krimet e Rënda kanë riformuluar akuzën për Bledar Tetën, të vetmin të arrestuar nga moskallëzim krimi, në vrasje e kryer me paramendim në bashkëpunim. Ky vendim është marrë nga prokurori Behar Dibra, i cili i ka komunikuar të ndalurit akuzën ndërsa i ka kërkuar Gjykatës së Krimeve të caktojë arrest me burg. Leonard dhe Elis Duka, Xhoni Nica, Oltian Loka, Ilir Selmani, Aleksandër Maxhaku, Dritan Agaj, Fatmir Hyseni janë personat e dyshuar si të përfshirë në këtë krim ndërsa prej ditësh janë shpallur në kërkim. Ekzekutimi i Malkos ndodhi më 27 gusht 2019 në rrugën "Xhanfize Keko" në Tiranë dhe nga ajo ditë i vetmi i ndaluar është Teta i cili u zbulua prej automjetit që përdorte dhe kamerat e sigurisë e fiksuan afër vendit ku i vra Santiago Malko, 26 vjeç. Mësohet se Xhoni Nica, një nga personat e shpallur në kërkim, me anë të avokatit të tij, Alban Qafa, pretendon se kur ka ndodhur vrasja ai ka qenë jashtë vendit. Provat, si pasaporta dhe biletat, avokati i tij i ka depozituar në prokurorinë e Krimeve të Rënda aty ku do të vlerësohen nëse janë apo jo të vërteta.

Pamje nga promovimi i librit me kujtime të Mit'hat Frashërit

Kujtimet e rralla, botohet vepra e katërt e Mid'hat Frashërit

Studiuesi Uran Butka, në nderim personalitetit të kulturës dhe politikës shqiptare, sjell të botuar përshtypjet e Mit'hat Frashërit për udhëtimet që ka bërë. Studiuesi shprehet se do t'iu kërkojnë shteteve të Bashkuara të Amerikës edhe ekspertizën e vdekjes së tij

VALERIA DEDAJ
TIRANE

Në 70-vjetorin e vdekjes së Mit'hat Frashëri botohet vepra e tij e katërt, me udhëpërshkrimet, që janë botuar në shtypin shqiptar edhe të huaj. Janë përshtypje udhëtimi, përshkrime gjeografike, historike, politike, etnike, sociale, ekonomike edhe kulturore, që drejtuesi i Institutit "Lumo Skëndo" studiuesi Uran Butka boton në këtë vëllim.

"Përmbledh të gjitha përshtypjet e udhëtimit në të gjithë hapësirën, që nga Stambolli, në Shkup edhe në Prishtinë, duke e zgjedhur edhe si delegatë, në Elbasan, në Vlorë ku është zgjedhur si firmëtar i Pavarësisë edhe në fund nga Janinë", thotë Butka.

Ndërsa, referuesit e tjerë ndalën tek vlerat dhe kontributi që Mi'that Frashëri ka dhënë në letërsinë shqiptare, edhe në çështjet kombëtare.

"Sot të gjithë shqiptarët kanë nevojë që të njihen me përpjekjet edhe sakrificat e mëdha, që shqiptarët dhanë për vendin. Që nga koha e komunizmit kemi një përqasje që historia fillon me mua. Por ka ardhur koha që të njohim baballarët e kombit, për të kuptuar të sotmen edhe të ardhmen, sepse duke mos e njohur të vërtetën do t'u thurim lavde sharlatanëve", shprehet ish-deputeti Agron Shehaj.

Në veprën e pestë të Mit'hat Frashërit do të përfshihen përshtypjet e udhëtarëve të huaj për Shqipërinë, ndërsa në veprën e gjashtë edhe të shtatë do të përfshihen të gjitha letërkëmbimet, e Mit'hat Frashërit. Por, megjithatë ajo që vazhdon që të mbetet mister sipas studiuesit është vrasja e Mit'hat Frashërit

"Mendoj se skenari i dytë i vrasjes së Mit'hat Frashërit që ishte vendosur nga sigurimi i shtetit shqiptar edhe qeveria shqiptare, ishte që ai të zhdukej para se të binte në kontakt me Vatrën. Ky është varianti më i besuar. Në bashkëpunim me agjentet e dyfishtë ata realizuan vrasjen me metoda kimike edhe ilaçe vrasjen e Mit'hat Frashërit. Ne do kërkojmë që qeveria amerikane të na zbulojë ekspertizën e vdekjes së tij, që nuk është zbuluar deri më sot", shprehet Butka.

Studiuesi Uran Butka aktualisht është duke përgatitur edhe albumin fotografik të Mit'hat Frashëit.

JETA DHE VEPRA

Kush ishte Mid'hat Frashëri, i njohur si Lumo Skëndo

Mid'hat Frashëri i biri i rilindasit të shquar Abdyl Frashëri lindi më 25 mars 1880 në Janinë. Ai njihet edhe me pseudonimet Lumo Skëndo dhe Mali Kokojka. Mid'hati e njohu shumë pak të atin e tij, ngaqë Abdyli vdiq i ri në burg. U rrit në kujdestarinë e xhaxhallarëve, rilindësve të shquar Sami dhe Naim Frashëri. Duke qëndruar pranë tyre, kreu edukimin e plotë akademik në Stamboll. Patriot, njeri i ditur, Mid'hat Frashëri ka mbajtur në zemër amanetin e të atit Abdyl Frashëri, i cili gjatë qëndrimit në burg, u vendos të ekzekutohej nga xhonturqit. Kur u pyetën Abdylin nëse dëshironte të thoshte diçka, ai është përgjigjur: "Po, unë kam një djalë të vogël. I thoni atij se në qoftë se dëshiron të ketë bekimin tim, duhet të vazhdojë punën që unë nisa, por mjerisht nuk e çova deri në fund dhe të sillet kështu siç po sillem unë".

Deri në vitin 1905, Mid'hati punoi në administratën turke dhe më pas kaloi në Selanik, në administratën shtetërore, i emëruar drejtor për punë politike të vilajetit të Selanikut. Filloi të aktivizohet në politikën shqiptare që në fund të shekullit XIX dhe u bë një nga figurat më të spikatura në politikën shqiptare. Mid'hat Frashëri ka qenë pjesëtar i klubit të Selanikut në Manastir, ku takoheshin patriotët shqiptarë. "Pati një rol të ndjeshëm në ruajtjen e kompaktësisë së klubit "Bashkimi" të Manastirit, pas mosmarrëveshjeve ndërmjet gegëve (në pjesën më të madhe dibranë) dhe toskëve, të cilën e ka zgjidhur duke shkuar në Manastir, më 20 shtator 1908, duke shkrirë kryesinë e mëparshme, të cilën e zëvendësoi me Rexhep Hoxhën prej Kallkandelene (Tetovë), zgjedhur kryetar, ish-kryetari Fehmi bej Zavalani kaloi zv/kryetar, ish-zv/kryetari Gjergj Qiriazi u zgjodh anëtar dhe kryesia u përbë nga pesë gegë e pesë toskë.", rrëfen studiuesi Uran Butka. Gjithashtu ai nisi të merrej me krijimtari letrare që prej vitit 1897 dhe filloi të botonte "Kalendarin Kombiar", të cilin e botoi pa ndërprerje deri në vitin 1928. Më 1901, botoi biografinë e parë kushtuar Naim Frashërit. Në botimet e ndryshme ai përdori edhe pseudonimin Ismail Malosmani.

Në korrik 1908 Mid'hat Frashëri themeloi gazetën "Liria" në Selanik, në vitet 1897-1928, botoi revistën "Kalendari Kombiar", më 1909 themeloi revistën "Dituria", në Selanik, pastaj në Kostancë dhe më vonë në Tiranë. Më 1908, mori pjesë dhe u zgjodh kryetar i Kongresit të Manastirit dhe nënkryetar i Komisionit të Alfabetit. Më 1909, 2-8.09, mori pjesë në Kongresin Kombëtar të Elbasanit. Mori pjesë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës më 28 nëntor 1912 si delegat i Përmetit, Elbasanit dhe Pejës dhe nënshkroi Aktin e Shpalljes së Pavarësisë.

Në qeverinë e Ismail Qemalit u emërua Ministër i Punëve Botore. Në kabinetet e Turhan Pashë Përmetit, në vitet 28.05.1914 – 03.09.1914, ishte Ministër i Punëve Botore dhe Post-Telegrafës, ndërsa në vitet 25.12.1918 – 29.01.1920, ishte Ministër pa Portofol. Ishte anëtar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris, në vitet 1919 – 1920.

Më 1920 përfaqësoi Shqipërinë në Lidhjen e Kombeve, në vitet 1923-1925 ishte ministër fuqiplotë i Shqipërisë në Greqi. Në vitet 1926 – 1939 hapi në Tiranë librarinë "Lumo Skendo".

I përndjekur nga regjimi komunist me akuzën si themelues i organizatës së Ballit Kombëtar, Mid'hat Frahsëri në përfundim të luftës u vendos në Itali e më vonë në Londër, ku krijoi Komitetin "Shqipëria e Lirë". Mid'hati Frashëri nuk u martua.

Varrimin e tij në SHBA e kanë organizuar përmes një ceremonie madhështore patriotët shqiptarë. Në gazetën "Flamuri" shkruhej: "Shqiptarët kanë ardhur nga të gjithë vendet nga ku banonin shqiptarët në mërgim, duke shprehur pikëllimin e madh,për ikjen e djalit të Abdylit njeriut të madh, Mithat Frashërit. Tek trupi i tij kanë bërë roje nderi Shefqet Isaraj,Muho Xhakja,Astrit Sako,Braho Husi,Sulo Male,Hysni Aliko,Hajredin Peshkëpia,Skënder Omari,Iliaz Guri,Luan Dosti. Arkivoli ishte i mbuluar me flamurin kombëtar dhe në sallë ishin 200 veta. Kortezhi për në varrezat "Fernchff". Arkivoli merret në krahë dhe aty kanë folur Sejfi Protopapa,At Paul e V.Rado.

Mid'hat Frashëri

Vdekja e Mit'hat Frashërit, dyshimet për helminin e tij nga agjentët e KGB-së

Ai u vendos në hotelin Vinthrop. Ishte shëndoshë e mirë dhe e nisi mbarë punën… Mirëpo për fat të keq, më 3 tetor 1949 ora 9.25, vdiq papritur. Si u hodhën tezat se Kim Philby me agjentët e fshehtë të KGB-së e asgjësuan si antikomunistët e tjerë të Lindjes si Stefan Bandera, Lev Rebet, Georg Markov

DR. URAN BUTKA
TIRANE

Uran Butka

Midhat Frashëri, udhëtoi në muajin shtator 1949 nga Parisi, ku shpalli formimin e Komitetin Shqipëria e lirë, për në Londër, ku dha një intervistë në BBC për programin e kësaj qeverie demokratike në emigracion. Në Ëashington, ku u prit nga kryetari i Komitetit Evropa e Lirë, Jozef Grei-Grei dhe zevendësndihmëssekretari i shtetit, Thomson.

Kreu i Komitetit Shqipëria e Lirë, ne fjalën e tij në pritje tha: " Shpresojmë ti japim zemër popullit shqiptar ne rezistencën kundër tiranisë komuniste dhe të ndihmojmë për të organizuar shqiptarët në kete luftë për demokraci". Aleatët anglo-amerikanë e caktuan selinë e Komitetit Shqipëria e Lirë dhe të kryetarit Midhat Frashëri në Neë York ..

Ai u vendos në hotelin Vinthrop. Ishte shëndoshë e mirë dhe e nisi mbarë punën, sipas programit që paraqiti në BBC. Mirëpo për fat të keq, më 3 tetor 1949 ora 9.25, vdiq papritur.

Sipas të dhënave të shoqëruesit që i rrinte pranë në atë çaste, Telhat Karagjozit dhe sipas ekspertizës të atypëratyshme mjekut ligjor, rezultoi që vdekja iu shkaktua nga një infarkt i miokardit. Ekziston edhe një variant i vrasjes (shkaktimit të infarktit nëpërmjet ilaçeve apo gazit nëpërmjet agjentëve të KGB-së). Kim Philby, agjent i dyfishtë, i cili kishte qenë në Londër në shtator të vitit 1949, kur ishte shpallur Komiteti "Shqipëria e lirë", ndërkohë që ishte nisur në atë kohë për në SHBA, mendohet se mund të ketë vepruar bashkë me agjentët e fshehtë të KGB-së, mbi Mid'hat Frashërin për ta asgjësuar, ashtu siç kishin vepruar edhe mbi disa personalitete të tjera antikomuniste të Lindjes si Stefan Bandera, Lev Rebet, Georg Markov.

Në mbështetje të këtij varianti është edhe një dokument i Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë, qe e kam zbuluat tash së voni, ku shkruhet:

"Në Amerikë është kolonia jonë më e madhe dhe qëllimi imediat i organizatorëve të këtij komiteti, veç zhurmës me radio e shtyp kundër qeverisë sonë, është që të shkëputë koloninë shqiptare të Amerikës dhe ta lidhë me reaksionin... Të merret në shqyrtim dhe të caktohet me hollësi një politikë e jona aktive ndaj kolonisë së Amerikës. Të studiohet një e nga një çdo person dhe të bëhet diferencimi. Midhat Frashëri nuk e fut dot këmbën kollaj në koloni. Po kështu edhe të tjerët. Po këto duhen bërë sa më parë"

Ishte vendimi I qeverisë komuniste dhe e Sigurimit të Shtetit Shqiptar për të asgjesuar Mid'hat Frashërin, pa shkelur tek Vatra dhe pa renë në konyakte me diasporën shqiptare. Dhe kështu u bë. Sigurimi Shqiptar njoftoi KGB Sovjetike, që I kishte kthetrat dhe në Nju York. Sigurisht kishte vepruar edhe spiuni I dyfishtë Kim Filb, që kishte udhetuar nga Londra për në Njy York në një kohë më Mid'hat Frashërin.

Trupi i Mid'hat Frashërit u varros me nderime në varrezat Ferncliff në Neë York. Një varr i thjeshtë, i sheshtë e në mes të barit, me emrin "Mid'hat Frashëri 1880-1049". Në emër të komitetit Shqipëria e lire foli Nuçi Kota, nënkryetar I Komitetit.

VËLLIMI I KATËRT I VEPRËS SË MID'HAT FRASHËRIT

Themelimi I Institutit të studimeve historike "Lumo Skendo, sipas testamentin që na la, ishte vepra e parë e rëndësishme kulturore, që mori përsipër botimin e plotë të vepërës së Midhar Frashërit, por edhe studime e botime të tjera me vlera kombëtare. Kthimi në atdhe i eshtrave të Midhat Frashëtit ishte akti madhor I kryer nga qeveria dhe shteti shteti shqiptar. Ceremonitë e përcjelljes në Neë York dhe e pritjes në Tiranë qene madheshtore. Ai tashme prehet pranë vëllezerve Frashëri dhe Konivës, në një vend të lartë ëee të gjelbëruar, nga ku donte te shikonte Shqipërinë e lirë dhe Shqiptarat në gëzimet dhe hidhërimet e tyre.

E famshme është shprehja e tij profetike:" Shqiptarët do t'I fitojne të gjitha betejat, pasi të mbarojmë betejat mes tyre"

Sot në përvjetorin e e 70 të vdekjes së tij, përurojme vëllimin e 4 të veprës së zgjedhur të Midhat Frashërit, pjesë e një kolane prej 12 vëllimesh, nje pasuri e jashtëzakonshme e historisë dhe kulturës shqiptare.

Ky vellim përmban kryesisht përshtypjet e udhëtimit të Midhat Frashërit, ne tete hapesirën dhëqiptare mandej dhe evropiane: ravgime, mbresa, përshkrime gjeorafike, historike, meditime filozofike, politike, sociale, arti, si dhe një galeri personazhes historike. Një histori e panjohur dhe një krijimtari e jashtëzakonshme për të njohur botën dhe veten tonë. Midhat Frasheri nje shqiptar i madh dhe nje evropian i madh.

Mid'hat Frashëri në BBC

Gruaja tentoi të fshihte armën, por autori e gjeti! Tre plumba vëllait, 1 nipit

Dy varimet e vëllezërve zhvillohen të ndara Sali Dakuca në Klos, babë e bir varrosen në Tiranë

Detaje të reja kanë dalë në dritë lidhur me tragjedinë në familjen Dakuci që tronditi Klosin më 1 tetor, ku vëllai vrau vëllanë, nipin dhe më pas veten. Sherri mes vëllezërve Sali dhe Kujtim Dakuci ka nisur për tre hunj gardhi, i cili ka agravuar më pas edhe me përdorimin e armës. Gruaja e Saliut, ka tentuar të parandalojë tragjedinë dhe kur ka parë që bashkëshorti i saj kishte hyrë në shtëpi, ka vrapuar për të fshehur armën, por nuk ia ka dalë dot. Sali kishte mbërritur para saj dhe sapo ka marrë pistoletën ka nxituar dhe ka dalë jashtë duke qëlluar tre herë në kokë vëllanë. Në mbrojtje të Kujtim Dakucit ka ndërhyrë djali i tij Flogerti, por fatkeqësisht e ka pësuar edhe ai, pasi xhaxhai e qëlloi me një plumb në gjoks. Po të njëjtat burime, bëjnë me dije se ato nuk janë varrosur pranë njëri-tjetrit.

EDHE VARIMET E NDARA

Sali Dakuci është varrosur në Klos dhe e kanë marrë përsipër nipat e tij dhe djali i vetëm që jetonte në Itali. E ndërsa Flogert dhe Kujtim Dakuci janë varrosur në Tiranë, tek familjarët e zonjës së shtëpisë. Dy familjet nuk kanë pasur një marrëdhënie të mirë me njëra-tjetrën. 9 vite më parë ato kanë përfunduar në gjykatë për një gjel. Sipas vendimit të gjykatës dhe dëshmive të protagonistëve të këtij krimi, gjeli i Kujtimit i ngacmonte pulat e Sali Dakuçit. Pikërisht për këtë gjel, që në fakt i përkist familjes së Kujtim Dakucit, babai 80-vjeçar i këtij të fundit Liman Dakuci dhe vëllai i tij Sali Dakuci, në vitin 2011 kanë përfunduar në gjykatën e Matit, si të pandehur për akuzën e "Dhunës në familje". Por gjatë gjykimit, babë e bir janë deklaruar të pafajshëm. Dëshmitare e ngjarjes ka qenë edhe motra e tyre, e cila kishte kishte shkuar në shtëpinë e prindërve, pas babai i saj 80-vjeçar Limani ishte i sëmurë rëndë. Ajo pohoi se kishte dëgjuar dy vëllezërit e saj teksa debatonin me njëri-tjetrin.

GJYQI PËR PULAT

Minishe Dakuçi, gruaja e Kujtimit akuzonte babain dhe vëllanë e burrit duke u shprehur se: "...Sali Dakuçci doli dhe gjuajti në një gjel dhe tha "...do ta mbys se me vret pulat...". Pastaj filloi të më shante mua me nënë e me motër. Në këtë kohë më mori burri në telefon për të pyetur për fëmijët, pasi në atë kohë punonte në Thekër Martanesh. Unë i thashë burrit se Saliu më ka sharë se i gjujti gjelit. Unë i thashë "...o i mbajmë mbyllur ose i heqim...". Në moment që isha duke folë në telefon Saliu më ka thënë ...oj kurvë të vi e të shti në tokë dhe ka ardhur dhe më ka gjuajtur në shtëpi në krahë. Në këtë momente ka ardhur dhe Limani dhe më ka gjuajtur me shkop. Unë për punë minutash kam njoftuar policinë dhe më thanë unë nuk pyes për policinë. Këtë punë e ka parë Selman Dakuçi, por ai nuk vete dhe nuk vjen dhe nuk flet me të akuzuarit dhe unë nuk e thërras si dëshmitar. Unë kam si provë aktin e ekspertimit. Ndërkohë gjatë procesit të gjykimit i moshuari Liman Dakuçi parashtroj para gjykatës duke thënë se "...kallëzuesen e njoh,është nusja e djalit tim. Unë e dëgjova se më ka akuzuar se e kam rrahur por unë nuk e kam bërë këtë. Unë jam 80 vjeç dhe nuk është e vërtetë se e kam rrahur. Ka bërë fjalë me Saliun për pulat siç tha. Nuk është rrahur. Djali im me Minushen janë në shtëpinë e tyre. Ajo është e lindur për të bërë ngatërresa me ne. E dëmtuara, e ka në gjak rrahjen pasi që kur ka ardhur nuse ka bërë katër rrahje. Një herë ka rrahur një nuse të një komshiu Mynyre Dakuçin e cila është gruaja e Asllan Dakuçit. Një herë më ka rënë mua dhe nuses time. Më vonë i ka rënë dhe nuses së Saliut dhe ka marrë nëntë ditë raporte. Ajo e fali kur bënë gjyq. Pastaj ka bërë kallëzim për ne. Sa ka ardhur nuse tek ne unë i kam rënë vetëm me një shpullë para dhjetë vitesh, se i kishte rënë vajzës së saj.

MIRDITË / 34-VJEÇARI QË U GJET I VRARË NË KANAL PËRDORTE DY EMRA

Eri Zefi u mor peng dhe u ekzektua 50 m larg Rrugës së Kombit

Detaje të reja nga vrasja e 34-vjeçarit Eri Zefi ndodhur një ditë më parë në Mirditë. Viktima mësohet se është marrë peng dhe më pas është ekzekutuar me një plumb në kokë pikërisht në vendin ku u gjet i vrarë, në Zall Xhuxhe. Dyshohet se ngjarja ka ndodhur disa orë para se të gjendej i pajetë nga një banor i zonës. Viktima u gjet i vrarë rreth orës 16:00 të së mërkurës në një zonë të pyllëzuar 50 metra larg rrugës së Kombit. Eri Zefi njihej edhe me emrin Anton Zefi dhe kishte pasaportizimin në Adriatik të Kurbinit, por bashkë me familjen e tij jetonte në Durrës. 34-vjeçari ishte i martuar dhe ishte baba i një fëmije. Policia ka shoqëruar disa persona të cilët po merren në pyetje. Vendi ku u gjet viktima është zonë e pabanuar, çka vështirëson punën e grupit hetimor për të zbardhur dinamikën e krimit. Dyshimet e para lidhur me këtë ngjarje bien pikërisht në një ngjarje të ndodhur pak muaj më parë ku vëllai i tij Ndue Zefi vrau me armë Martin Ndrecën në sy të djalit të tij 10-vjeçar. Kjo ngjarje ka ngritur dyshimet se vrasja e Eri Zefit ditën e sotme mund të jetë kryer për shkaqe hakmarrje nga të afërm të viktimës që vëllai i tij la më 24 shkurt të këtij viti. Pak kohë pas vrasjes Arben Ndreca, vëllai i Martin Ndrecës tha në një rrëfim për Shqiptarja.com, se vëllai i tij nuk u vra për çështje nderi, siç u përfol në disa media. Sipas tij konflikti mes vëllait të tij dhe Ndue Zefit ka ndodhur për një sherr krejtësisht banal në një lokal: "Pse më shikon".

TEPELENË E MEMALIAJ

Ndalohen 4 ish-zyrtarë, tender fiktiv për pajisjen e spitalit me leje mjedisore



Katër ish-zyrtarë janë ndaluar nga policia pasi kanë bërë një tender fitktiv për pajisjen me leje mjedisore të spitalit të spitalit të Tepelenës dhe Memaliaj duke përvetësuar një shumë të konsiderueshme lekësh. Bëhet fjalë për një tender të vitit 2017.

Mësohet se ndaluar Gëzim Allkushi me detyrë ish-shef finance Sajmir Meçe, specialist statistike, Aleksandra Kada, ish-juriste dhe Jonida Sako, ish-specialiste e burimeve njerëzore. Siç njoftojnë uniformat blu, këta katër ish-zyrtarë akuzohen për vjedhje në bashkëpunim e falsifikim dokumentesh, duke shpërdoruar detyrën. Gjithashtu, në kuadër të këtij operacioni të quajtur "Tender" u referuan materialet në Prokurori edhe për një subjekt privat në fushën e "Shërbimeve të konsulencave për ndikimin në mjedis" me inicialet E.L. Mbi ta rëndon akuza për veprat penale "Vjedhja duke shpërdoruar detyrën" në bashkëpunim, "Vjedhja në bashkëpunim" dhe "Falsifikimi i dokumenteve".

Pas hetimeve që kanë zgjatur rreth disa muaj, u arrit të dokumentohej kjo veprimtari e paligjshme e katër ish-zyrtarëve.

NGJARJA

Aksident në aksin Levan-Fier, kamionët përplasen kokë më kokë

Një aksident i frikshëm ka ndodhur në rrugën Levan-Fier, ku në vendin e quajtur "Fabrika e Bukës", në lagjen 1 Maji, janë përplasur dy maune. Përplasja ka qenë shumë e fortë, por fatmirësisht nga ky aksident nuk ka patur asnjë person të lënduar, por vetëm dëme materiale. Ndërkohë policia ka shkuar në vendin e ngjarjes dhe po heton për zbardhjen e plotë të saj. Nga dyshimet paraprake thuhet se shkak i këtij aksidenti është bërë lagështia në rrugë.

Paradë
FJALËKRYQESH

DUHET TË NXINI **37** KUTI

FJALËKRYQI PA SKEMË

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1																	
2																	
3																	
4																	
5																	
6																	
7																	
8																	
9																	
10																	
11																	
12																	

HORIZONTAL
1. Janë grindje.
-Një mund të jetë studimi.
-Gjysmë akordi
2. Lindi Isakun.
-Kështu përfundon një katil
-Një top në rrjetë.
3. Fillojnë ilustrimet.
-Kapen të parat.
-Muzika e Eminem.
-Skuadër greke.
-Në krye të masave
4. De Sio këngëtare.
-Është fusha e Oersted.
5. Film i Alan Parker.
-Janë artistë ëndërrues.
6. Është shoshë.
-Satelit i Uranit.
-Pak analogji.
7. Skandali fatal për Richard Nixon.
8. Mund të jenë mallrash.
-Teket e një sfere.
-Mund të jetë hidraulike.
9. Është e gjithë.
-Litra pa kufij.
-Një mund të kërkohet politik.
10. Inicialet e Banderas.
-Numër i shkurtër.
-Të parat në stadium.
-Një mund të jetë bankare.
11. Është faturë me... nota
-Dënohej nga Inkuizicioni një e tillë.
-Fillojnë fazën.
12. Woody i kinemasë.
-Janë përmasa.

VERTIKAL
1. Bëjnë xhiro me para.
-Negri poete.
2. Në mes të Rita dhe Montalcini nobeliste.
-Është shpirti i atij që ngre krye.
3. Në fund të ndeshjes.
-Mund të jenë të larta në një ndeshje të shpejtë.
4. Mund të jetë balistike.
-Aq ishin muzat.
5. Është plloçë.
-Beatty aktor.
6. Inicialet e Asimov.
-Hari spiune.
7. Një mund të jet kalenmdarik.
-Pak sadiste
8. Bëjnë sevap.
9. Bëhen me shitblerje.
-Hutim në ekstreme.
10. Diftong në duar.
-Rogers që qe partnere e Fred Astaire.
-Ekstreme në ekstreme.
11. Është elektrodë pozitive.
-Kuron pa zë.
12. I dëgjoi vetëm Odiseu.
-Marsi i akejve
13. Është 5 në një grup muzikor.
-Inicialet e Gould aktor.
-Ente Zyrtare Informacioni.
14. Është radha.
-Një Plus 2 për t'u dëgjuar.
15. Inicialet e Gide.
-Këndon i pari.
16. Eshtë yll me bisht.
-Qendër mësimi.
-Një Santa në New Mexico.
17. Vala e stadiumit.
-Mund të jenë operacioni.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

K	A	P	E	D	A	N	I	■	K	S	■	G	■	M	O	T
A	P	A	T	I	K	U	■	B	U	F	■	O	S	A	K	A
P	A	R	A	T	E	■	P	E	R	I	O	D	I	K	E	T
E	R	A	■	A	■	K	I	N	O	D	R	O	M	E	T	■
L	A	R	A	■	K	A	T	A	R	A	K	T	E	T	■	F
A	T	E	■	F	I	T	O	R	E	T	■	■	N	■	M	A
T	E	N	■	I	M	■	N	E	N	■	M	A	O	R	E	T
■	■	D	E	D	O	■	I	S	■	T	O	R	N	A	D	O
S	T	E	F	A	N	O	■	■	M	A	T	A	■	M	U	R
T	E	S	■	N	O	R	M	A	■	K	O	B	E	■	Z	I
E	M	I	L	E	■	A	N	E	T	A	R	E	■	I	A	N
■	A	T	A	T	U	R	K	■	I	T	E	T	I	■	T	O

HOROSKOPI

DASHI
Ka rrezik qe tundimi te jete shume i forte sot për ju qe keni një lidhje dhe do ju duhet shume sforcim për te mos përfituar nga rastet qe do iu jepen. Ju ne fakt e doni shume partnerin dhe nuk doni ta humbisni. Beqaret do bëjnë edhe sakrifica vetëm për te arritur qëllimin e tyre. Sot do jene me më shume fat. Ne planin financiar fati do jete gjithë kohës ne favorin tuaj dhe gjendja do mbetet e kënaqshme.

DEMI
Te dashuruarit do jene me te gatshëm për te folur hapur me partnerin e tyre e për te zgjidhur te gjitha mosmarrëveshjet qe deri me sot i kishin mbajtur ne ankth. Beqaret me ne fund do merren ne mbrojtje nga yjet dhe gjerat kane për t'iu ecur me se miri. Ne planin financiar gjendja do jete e qëndrueshme kështu qe nuk është nevoja te bëni sakrifica ekstreme për t'i shtuar me tepër te ardhurat.

BINJAKET
Për një jete edhe me te lumtur ne çift, sot duhet te bëni me tepër lëshime. Marsi do jete ne anën tuaj dhe do ju ndihmoje, por ama edhe ju duhet te bëni përpjekjet tuaja. Beqaret nuk do kenë mundësi për dashuriçka pasiononte, por do kaloni një dite fantastike me miqtë me te ngushte. Me shpenzimet ka rrezik te tregoheni te pamatur dhe gjendja ne fund te ditës do dobësohet goxha.

GAFORRJA
Do jeni shume te duruar, te logjikshëm dhe tolerante sot ju te dashuruarit. Te gjitha këto karakteristika do bëjnë qe marrëdhënia me partnerin te ece mire dhe te mos keni debate. Beqaret do ndiheni si neper ëndrra pas gjerave qe do ju ndodhin. Edhe ne planin financiar keni për te pasur me shume fat nga me pare. Shfrytëzojeni rastin për te bere çdo shpenzim qe keni ëndërruar.

LUANI
Ndikimi i Merkurit do jete shume i mire sot për ju qe keni një lidhje. Do përfitoni nga koha e lire për te folur me partnerin për gjithçka qe ju ka shqetësuar deri me sot. Beqareve do ju afrohet një person qe kërkon vërtet te krijoje një familje me ta. Ne planin financiar fati do ju buzëqeshë gjate gjithë kohës. Do ndiheni mire dhe me te lirshëm për te kryesh shpenzimet e nevojshme.

VIRGJERESHA
Klima yjore do e favorizoje akoma me shume jetën tuaj ne çift sot. Do i harroni njëherë e përgjithmonë problemet qe keni pasur dhe do ndiheni me te qete se me pare. Beqaret kot sa te lodhen duke kërkuar dashurinë sepse do jene te pafat sot. Buxhetin duhet te mundoheni ta mbani me tepër nen kontroll pasi po filluan problemet nuk do arrini dot ta ndalni shkatërrimin.

PESHORJA
Do jeni tejet sharmante gjate kësaj dite dhe partneri do ndihet me fat qe ju ka pranë. Para te tjerëve ai do ndihet krenar pasi si ju nuk ka shume te tjerë. Beqaret me mire le te lënë veten te lire dhe le te përfitojnë nga çdo mundësi qe do iu jepet. Jeta është e shkurtër dhe duhet shfrytëzuar. Për financat yjet këshillojnë kujdes dhe sa me tepër maturi. Po e arritët këtë do përfitoni.

AKREPI
Do keni goxha probleme ne jetën tuaj ne çift gjate kësaj dite dhe ne ndonjë moment do mendoni edhe te ndaheni përfundimisht. Do ndiheni keq dhe mund te qani për disa gjera. Beqaret ka gjasa te krijojnë iluzione te kota dhe realiteti do ju duket me zhgënjyes. Ne planin financiar duhet thjesht te tregoheni pak me te matur dhe gjendja do filloje te normalizohet.

SHIGJETARI
Jeta juaj ne çift do jete shume e qete sot. Do bëni çdo gjë qe do e mendoni te arsyeshme dhe kënaqësitë do jene me te shumta. Beqaret nuk do duan te kenë ndryshime te statusit edhe pse ne fakt disa persona do mund t'iu ofrojnë një jete te qete e te rehatshme. Shpenzimet ulini ne maksimum dhe keni për te rigjetur ekuilibrin qe ju kishte munguar kohet e fundit.

BRICJAPI
Nëse kohet e fundit jeni ndier te vetmuar apo keni pasur probleme me partnerin, sot do jete dita e duhur për te hedhur hapat e para drejt stabilizimit te situatës. Te dy do bëni përpjekje. Beqaret nuk do e kenë mendjen tek krijimi i një lidhjeje, kështu qe do ja lënë çdo gjë ne dore kohës. Ne planin financiar situata do vije duke u përmirësuar kështu qe vazhdoni ne rrugën e nisur.

UJORI
Jupiteri do jete planeti qe do ua përmirësojë jetën tuaj ne çift sot. Do rrezoni çdo tabu dhe do ndiheni me te lirshëm se me pare. As nuk do hezitoni te hidhni hapa te reja. Beqaret duhet te mendohen mire dhe te gjejnë personin qe do iu përshtatet plotësisht, para se te hedhin hapa. Ne planin financiar nuk do keni me vështirësi si me pare prandaj do ndiheni shume me te qete.

PESHQIT
Dite e ekuilibruar ka për te qene kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Here pas here do keni edhe momente te lumtura. Beqaret jo vetëm qe do kenë takime, por mund te sakrifikojnë çdo gjë vetëm qe te fillojnë një lidhje afatgjate. Ne planin financiar do keni disa vështirësi dhe me zor do ja dilni te kryeni edhe shpenzimet me te nevojshme

SUDOKU

PLOTËSONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGA 1 9

	3				4			
		5	6	3	9	2		7
	9		1		2		8	
9	6	4		8		1	3	
	2		4		1		6	
	8	1		6		9	5	4
	4		5		6		7	
1		9	3	4	8	6		
			9				1	

PËRGJIGJE

5	9	4	1	6	3	7	8	2
2	6	3	5	8	7	4	1	9
8	7	1	9	4	2	3	6	5
4	8	9	6	7	5	2	3	1
3	1	5	2	9	4	8	7	6
6	2	7	8	3	1	5	9	4
9	4	2	7	1	8	6	5	3
7	3	6	4	5	9	1	2	8
1	5	8	3	2	6	9	4	7

FJALËKRYQI SPORTIV



			1	2	■	■	3	■	4			■	5	■	6	7
			8		9	■	10	11		■	■	12		13		
			■	14		15				16	■	17				
			18	■	19						20	■	21			■
22	23	■	24		25					■		■	26			
27		■	28			■	29		■	■	30	31				■
32		33	■		■	34	35	■		■	36					
37			38	■	39	■	40	41	■	42		■	■			
43				44		45			46							
	■	47										■	■			



HORIZONTAL
1. Në krye të grupit
4. ... stop në box
6. Janë në masë
8. Johnson ish-kampion i atletikës
10. Institucione Civile Operative
12. Ai i rekordeve është Guinness
14. Kreshniku i volejbollit
17. Miroslav, ish-bomber gjerman
19. Janë të rënda me peshëngritjen
21. Është nusja me vello
22. Inicialet e Selleck
24. Lippi trianer
26. Një katror për knock out
27. Fillojnë aksionin
28. Jordi te Barça
29. Ekstreme në Otranto
30. Ndoshta është ndryshe
32. Një pjesë e Toskërisë
34. Kufizojnë një rival
36. Marubi i fotografisë
37. Lallana mesfushor anglez
40. Ekstreme në ekstreme
42. Në hyrje të sallës
43. Personazhi në foto
47. Personazhi në foto

VERTIKAL
1. George Best.
2. Rreth pa ekstreme
3. Një bomber te Las Palmas
4. Luan në Estádio do Dragão
5. Markë motoçiklete
6. Ëenger trainer
7. Teke stine
9. Organizon garat stock car
11. Tevez bomber
12. Laik kur s'është ai
13. Becker ish tenist
15. Reparte Prodhimi Elbasan
16. Diftong në dietë
18. Altin ish-mesfushor
20. ... out në basket
22. Një tapet për judo
23. Makina Felicia
24. Në krye të masave
25. Roberto Benigni
31. Të parat në bllok
33. Errani teniste
35. Skuadër franceze
36. Ricárdo as brazilian
38. Gjysmë minare
39. Janë të ndryshme në damar
41. Luarasi aktore
42. Një fuoristrada veturë
44. Janë në modë
45. Kufizojnë ambiente
46. Ekstreme në zabel

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV



FJALEKËRYQI
I KRIPTOGRAFUAR

■	2		■	■	■	■	■	17	1	15	8	1				
4 B	3 O	6 N	2 D	■	11	■	15	1	■	4	17	13				
1	■	4	5	12	8	13	1	7	8	■	■	5				
6	4	■	4	1	10	8	7	5	13	8	1	■				
11	1	7	1	4	8	6	1	9	5	■	12	2				
1	6	■	9	17	11	■	2	5	10	3	2	5				
9	2	■	5	7	■	15	1	9	17	7	5	■				
■	8	■	9	5	■	1	8	■	7	1	4	■				
12	9	2	■	13	8	9	■	9	8	7	1	6				
5	5	■	5	9	6	8	11	5	■	5	7	8				
18	9	■	2	5	7	10	1	6	■	9	1	6				
1	■	18	9	8	1	11	■	■	■	■	6	3				

PËRGJIGJE

D	I	G	A	■	P	A	G	A	N	E	■	T				
I	K	O	N	A	■	■	O	■	■	■	K	A				
S	E	L	I	■	K	A	S	T	I	L	E	■				
K	R	I	■	D	E	N	T	I	S	T	I	■				
U	■	■	D	A	N	A	I	D	A	T	■	M				
T	■	L	U	N	D	R	A	■	■	■	D	O				
I	D	U	■	I	E	K	■	S	A	D	■	D				
M	■	S	H	E	T	I	T	E	S	E	■	E				
E	I	P	■	L	■	S	H	E	K	U	L	L				
T	R	A	V	I	A	T	A	■	E	■	I	■				
■	I	T	E	■	H	E	R	E	T	I	K	E				
A	S	■	P	R	I	T	E	■	I	S	A	R				

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË

Alba MALLTEZI **DREJTORE E PËRGJITHSHME E FREE AND FAIR MEDIA GROUP ;** Aurel PEPA ***KRYEREDAKTOR***
Patricia COSTANTINESCU ***ADMINISTRATORE E PËRGJITHSHME*** ; Admirina PEÇI ***KRYEREDAKTORE E "RILINDASI" ;***
LAYOUT DESIGN : Altin ALIAJ, ***SHPËRNDARJA:*** Spiro MESHINI ***CEL:*** +355696088847

Departamenti i Marketingut: Patricia Costantinescu
Cel: +355696060419 - *marketing@shqiptarja.com*

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë Tiranë. ***E mail:*** shqiptarja.com@hotmail.com ***Website:*** www.shqiptarja.com ***Mobile:*** +355696060421 Shtypur në shtypshkronjën: KLASS shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë

INTERVISTA NE REPORT TV

Luiza Gega rekord në Botëror pa masazhator e fizioterapist

Kampionia e atletikës shkroi historinë për Shqipërinë shprehet se mund të kishte bërë më mire po të kishte kushte

Luiza Gega shkroi historinë në atletikën shqiptare kur pak ditë më parë kur u rendit e nënta në garën e 3000 metrave me pengesa në Botërorin e Katarit. Në një intervistë për report TV ajo shprehet shumë e lumtur për këtë arritje, por thekson se mund të kishte bërë më shumë në rast se do të kishte patur kushtet.

ReportTV e takon Luiza Gegën në kodrat e Parkut të Liqenit në Tiranë. Pas suksesit të arritur në botërorin e Dohas, atletja shqiptare vazhdon të stërvitet pa pistë, pa masazhator, pa fizioterapist. E megjithatë ajo është optimiste dhe kërkon gjithnjë më shumë nga vetja.

Katër ditë më parë atletia Luiza Gega shkroi historinë në mbretereshën e sporteve duke u bërë e para shqiptare që garon në një finale Botërori. Kjo gjithsesi nuk ishte arritja e vetme pasi Gega u rendit e nënta nga 15 sportistë, por në të njëjtën kohë theu edhe rekordin kombëtar me kohën 9 minuta, 19 sekonda dhe 93 të qintat. Të mërkurën në darkë ajo është kthyer nga Katari, por sot në mëngjes e gjen duke vrapuar në kodrat e liqenit. Në një intervistë për 'report tv' 31-vjeçarja shprehet se është shumë e lumtur për atë që arriti në botëror: "Unë sapo jam kthyer nga Doha dhe jam vërtet e lumtur që u riktheva me objektiva të arritura. E kisha deklaruar dhe më parë se kush janë këto objektiva. Ishte futja në finale dhe aty do mundohesha të pozicionohesha sa më mirë dhe të vendosja rekord të ri kombëtar. Rekordi i ri kombëtar do të thotë se ti je në formën më të mirë. Pra ke arritur një rezultat që se kisha arritur kurrë më parë. Unë në fakt nuk isha futur kurrë në një finale të tillë dhe vërtete e dojë këtë. Duke parë rezultat që kisha mundësitë ishin, por sigurisht që gara është garë dhe ti kurrë nuk e din."

Performanca në botëror ishte brilante, por Gega tregoi se mund të kishte bërë më shumë. "Në fazën e eliminatoreve nuk u ndjeva ashtu siç duhej. Arsyeja është se nuk kisha fizioterapist dhe masazhatorë. Këto nuk i kisha dhe kështu nuk isha në formën time më të mirë."- deklaroi atletia.

Gega tani duhet të stërvitet për garat e ardhshme, por realiteti shqiptar është shumë i hidhur. "Ja unë jam në Tiranë dhe nuk kemi një pistë vrapimi."-u shpreh më pas sportisja. Pavarësisht të gjithave Gega është kualifikuar për Lojtarat Olimpike të Tokios vitin e ardhshëm për të cilat deklaroi se synon sërish të shkojë në finale.

KATEGORIA SUPERIORE

Ndryshojnë oraret, tre ndeshje me ndriçim artificial

Ndryshojnë oraret e 3 nga 5 ndeshjet e javës së 7-të të Kategorisë Superiore, të shpërndara në dy ditë, e shtunë dhe e diel. Fillimisht FSHF kishte njoftuar se të gjitha takimet do të luheshin në orën 14:00, por institucioni i futbollit ka pranuar që disa prej dytë të luhen me ndriçim artificial.

Sfidat që u ndryshon orari nga 14:00 në 17:00 janë Skënderbeu-Luftëtari dhe Flamurtari-Tirana, që do të zhvillohen ditën e shtunë, dhe Kukësi-Vllaznia që do të luhet të dielën në "Elbasan Arena".

E SHTUNË	
Partizani-Teuta	14:00
Flamurtari-Tirana	17:00
Skënderbeu-Luftëtari	17:00
E DIEL	
Laçi-Bylis	14:00
Kukësi-Vllaznia	17:00

"YLLI" I SALZBURGUT

Haland: Kam kopjuar dietën e Ronaldos, Ibrahimovic idhulli im

Quhet Erling Braut Haland. Emri i tij hyri në histori kur në Kupën e Botës U-20, në Poloni, disa muaj më parë, ai shënoi nëntë gola në të njëjtën ndeshje me ekipin e tij, Norvegjinë. Këtë verë u transferua te Salzburgu dhe në një kohë shumë të shkurtër u shndërrua një nga "yjet" që po shkëlqen në Champions. Në debutimin e tij, kundër Genk, realizoi tregolësh. Këtë të mërkurë, kundër Liverpoolit, në "Anfield", realizoi një tjetër. Në total, katër gola në dy ndeshje për sulmuesin e ri 19-vjeçar. "Doja që në fillim që ai të bëhej futbollist. Erling bëri të gjitha sakrificat dhe u largua nga shtëpia kur ishte 16 vjeç për t'u transferuar te Molde. Ai është një profesionist i vërtetë. Përpiqet të bëjë të njëjtën gjë si Cristiano Ronaldo, i cili, pavarësisht se është 34 vjeç, mbetet në majë. Ai ka kopjuar dietën e tij," – pranoi babai i tij, Alfie, në një intervistë për ESPN. Në një intervistë të fundit, i riu Haland tha se ambicia e tij ka qenë Premier League: "Jam shumë i lumtur në Salzburg. Unë duhet të vazhdoj të përmirësohem dhe të shënoj gola. Premier League ka qenë gjithmonë frymëzimi im, turneu që më tërhoqi më së shumti. Një idhull? Ibrahimoviç, i cila është gjithashtu skandinav si unë ... "

RICCIARDO GAGLIOLO

Habit Suedia grumbullon mbrojtësin italian në kombëtare

Kombëtarja e Suedisë do të luajë dy ndeshjet e radhës eliminatore të Europianit 2020 përballë Maltës dhe Spanjës, konkretisht më 12 dhe 15 tetor, ndërsa trajneri Janne Andersson ka thirrur në skuadër edhe një mbrojtës italian. Bëhet fjalë për futbollistin e Parmës, Ricciardo Gagliolo, i cili luan prej dy sezonesh titullar në Serinë A, me skuadrën dukale, duke tërhequr vëmendjen e skandinavëve, me shpejt sesa atë të trajnerit të Italisë, Roberto Mancini.

Në fakt suedezët kanë përfituar nga fakti që mamaja e Gagliolos është nga Suedia dhe për këtë arsye edhe vetë mbrojtësi mban pasaportën e vendit, gjë që lehtësoi ndjeshëm procedurat për ta bërë pjesë të skuadrës për eliminatoret e radhës. "E kemi mbajtur nën vëzhgim për një kohë shumë të gjatë dhe kemi vendosur ta grumbullojmë pasi ka bërë mjaft mirë me Parmën, ku është titullar i padiskutueshëm. Mezi presim ta njohim nga afër dhe të shohim të na ndihmojë në fushën e lojës", tha trajneri Andersson në intervistën për mediat suedeze.